

URDHËR
Nr. 120, datë 6.11.2017

**PËR SHPALLJEN E DISA NDRYSHIMEVE NË STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË
KONTABILITETIT DHE TË RAPORTIMIT FINANCIAR, TË PËRKTHYERA NË
GJUHËN SHQIPE**

Në mbështetje të nenit 4, pikës 3, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2014, “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, të ndryshuar, të vendimit nr. 1, datë 27.9.2014, të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, “Për miratimin e përkthimit në gjuhën shqipe të ndryshimeve të ndodhura për SNRF-të gjatë vitit 2016”, të cilat hyjnë në zbatim pas datës 1 janar 2017,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e ndryshimeve të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), si më poshtë:

Titulli	Data efektive
Ndryshime në SNK 12, tatimet mbi të ardhurat	1 janar 2017
SNRF 1, Përmirësimet vjetore në SNRF-të, periudha 2014-2016	1 janar 2018
Ndryshime në SNRF 4, Kontrata e sigurimit	1 janar 2018
Ndryshime të SNK 7, Flukset e mjeteve monetare	1 janar 2017
Interpretimi 22, Transaksionet dhe paradhënia në monedhë të huaj	1 janar 2018
Ndryshime në SNRF 2, Pagesa të bazuara në aksione	1 janar 2018
Ndryshime në SNRF 15, Të ardhura nga kontrata me klientët	1 janar 2018
Ndryshime në SNK 40, Aktiv afatgjatë material i investuar	1 janar 2018

2. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Arben Ahmetaj

NJOHJA E AKTIVEVE PËR TATIME TË SHTYRA PËR HUMBJET E PAREALIZUARA

**Njohja e aktiveve për tatime të shtyra për humbjet e
perealizuara**

(Ndryshime të SNK 12)

Ndryshime të SNK 12 *Tatimet mbi të ardhurat*

Paragrafi 29 është ndryshuar dhe janë shtuar paragrafët 27A, 29A, dhe 98G. Gjithashtu, pas paragrafit 26 është shtuar një shembull. Teksti i ri është i nënvizuar. Paragrafët 24, 26(d), 27 dhe 28 nuk janë ndryshuar, por janë përfshirë për lehtësi referimi.

Diferencat e përkohshme të zbritshme

24 Një aktiv për tatime të shtyra njihet për të gjitha diferencat e përkohshme të zbritshme për aq sa ato ka mundësi të mbulohen nga fitimi i tatueshëm që do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit të mund të përdoret diferenca e përkohshme e zbritshme, përveç rastit kur aktiv për tatime të shtyra krijohet nga njohja fillestare e një aktivi ose detyrimi në një transaksion që:

- (a) nuk është një kombinim biznesi; dhe
- (b) në kohën e transaksionit, nuk ndikonte as në fitimin kontabël dhe as në fitimin e tatueshëm (humbjen e tatueshme).

Megjithatë, për diferencat e përkohshme të zbritshme që lidhen me investimet në filiale, degë e pjesëmarrje, dhe interesat në sipërmarrjet e përbashkëta, aktiv për tatime të shtyra do të njihet në përputhje me paragrafin 44.

...

26 Më poshtë janë dhënë shembuj të diferencave të përkohshme të zbritshme të cilat rezultojnë në aktive për tatime të shtyra:

- (a) ...
- (d) disa aktive mund të mbahen me vlerën e drejtë, ose mund të rivlerësohen, pa bërë një rregullim të ngjashëm për qëllimet tatimore (shih paragrafin 20). Një diferencë e përkohshme e zbritshme krijohet në qoftë se baza tatimore e aktivit tejkalon vlerën e tij kontabël.

Shembull që ilustron paragrafin 26(d)

Identifikimi i një difference të përkohshme të zbritshme në fund të vitit 2:

Njësia ekonomike A blen për një vlerë 1,000 NjM, në fillim të vitit 1, një instrument borxhi me një vlerë nominale prej 1,000 NjM e pagueshme në fund të maturimit për 5 vjet me një normë interesi prej 2% i pagueshëm në fund të çdo viti. Norma efektive e interesit është 2%. Instrumenti i borxhit matet me vlerën e drejtë.

Në fund të vitit 2, vlera e drejtë e instrumentit të borxhit ka rënë në 918 NjM si rezultat i një rritje në normat e interesit të tregut në 5%. Ekziston mundësia që njësia ekonomike A do mund të mbledhë të gjitha flukset e mjeteve monetare kontraktuale, nëse ajo vazhdon të mbajë instrumentin e borxhit.

Çdo fitim (humbje) e instrumentit të borxhit është e tatueshme (e zbritshme) vetëm kur realizohet. Fitimet (humbjet) që dalin nga shitja apo maturimi i instrumentit të borxhit janë llogaritur për qëllime tatimore si diferencë midis shumës së mbledhur dhe koston fillestare të instrumentit të borxhit.

Prandaj, baza tatimore e instrumentit të borxhit është kostoja e saj origjinale.

Diferenca midis vlerës kontabël neto të instrumentit të borxhit në pasqyrën e pozicionit financiar të Njesisë ekonomike A prej 918NjM dhe bazës së tij tatimore prej 1,000 NjM jep një diferencë të zbritshme të përkohshme prej 82NjM në fund të vitit 2 (shih paragrafët 20 dhe 26 (d)). pavarësisht nëse njësia ekonomike pret të rikuperojë vlerën kontabël të instrumentit të borxhit nga shitja ose nga përdorimi apo jo, qoftë duke mbajtur atë apo duke mbledhur flukse monetare kontraktuale, ose dhe nga kombinimi i të dyjave.

NJOHJA E AKTIVEVE PËR TATIME TË SHTYRA PËR HUMBJET E PAREALIZUARA

Shembull që ilustron paragrafin 26(d)

Kjo është për shkak se diferenca e përkohshme të zbritshme janë diferenca në mes vlerës kontabël të një aktivi ose pasivi në pasqyrën e pozicionit financiar dhe bazës së tij tatimore e cila rezultojnë në shumën që janë të zbritshme në përcaktimin e fitimit të tatueshëm (humbjes tatimore) të periudhës të ardhshme, kur shumën kontabël e aktivit ose detyrimit rikuperohet ose shlyhet (shih paragrafin 5). Njësia ekonomike A në momentin e shitjes ose të maturimit zbret një shumë ekuivalente me bazën tatimore të aktivit prej 1,000 NjM për efekt të përcaktimit të fitimit të tatueshëm (humbjes tatimore).

- 27 Rimarrja e diferencave të përkohshme të zbritshme rezultojnë në zbritje në përcaktimin e fitimeve të tatueshme të periudhës të ardhshme. Megjithatë, përfitimet ekonomike në formën e reduktimeve në pagesat tatimore do të rrjedhin tek njësia ekonomike vetëm në qoftë se ajo gjeneron fitime të tatueshme të mjaftueshme kundrejt të cilave mund të kompensohen zbritjet. Për këtë arsye, njësia ekonomike njeh aktivet për tatime të shtyra vetëm kur është e mundur që fitimet e tatueshme do të jenë të disponueshme kundrejt të cilave mund të kompensohen diferenca të përkohshme të zbritshme.
- 27A Kur një njësia ekonomike vlerëson nëse do ketë fitime të tatueshme të disponueshme kundrejt të cilit ajo mund të përdorë një diferencë të përkohshme të zbritshme, njësia ekonomike duhet të konsiderojë nëse ligji tatimor kufizon burimet e fitimit të tatueshëm kundrejt të cilit ajo mund të bëjë zbritje në rimarrjen e kësaj difference të përkohshme të zbritshme. Nëse ligji tatimor imponon kufizime të tilla, një njësia ekonomike vlerëson një diferencë të përkohshme të zbritshme në kombinim me të gjitha diferenca të tjera të saj të përkohshme të zbritshme. Megjithatë, në qoftë se ligji tatimor kufizon përdorimin e humbjeve si zbritje ndaj të ardhurave të një lloji të veçantë, një diferencë e përkohshme e zbritshme vlerësohet në kombinim vetëm me diferenca të përkohshme të zbritshme të tjera të llojit përkatës.
- 28 Është e mundur që fitimi i tatueshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit një diferencë e përkohshme e zbritshme mund të përdoret kur ka diferenca të përkohshme të tatueshme të mjaftueshme që lidhen me të njëjtin organ tatimor dhe të njëjtën njësia ekonomike, të cilat pritet të rimerren:
- (a) në të njëjtën periudhë me rimarrjen e pritshme të diferencës së përkohshme të zbritshme; ose
 - (b) në periudhat në të cilat, një humbje tatimore që krijohet nga aktivi për tatime të shtyra, mund të mbartet përpara ose mbrapa në kohë.
- Në këto rrethana, aktivi për tatime të shtyra njihet në periudhën në të cilën krijohen diferenca të përkohshme të zbritshme.
- 29 Kur diferenca të përkohshme të tatueshme që lidhen me të njëjtin organ tatimor dhe të njëjtën njësia ekonomike, janë të pamjaftueshme, aktivi për tatime të shtyra njihet për aq sa:
- (a) është e mundur që njësia ekonomike të ketë fitim të tatueshëm të mjaftueshëm që lidhet me të njëjtin organ tatimor dhe të njëjtën njësia ekonomike në të njëjtën periudhë me rimarrjen e diferencës së përkohshme të zbritshme (ose në periudhat në të cilat, një humbje tatimore që krijohet nga aktivi për tatime të shtyra, mund të mbartet përpara ose mbrapa në kohë). Për të bërë vlerësimin nëse do të ketë fitim të tatueshëm të mjaftueshëm në periudhat e ardhshme, njësia ekonomike:
 - (i) krahason diferenca të përkohshme të zbritshme me fitimin e tatueshëm të ardhshëm i cili përjashton zbritjet tatimore që rezultojnë nga rimarrja e këtyre diferencave të përkohshme të zbritshme. Ky krahasim tregon shkallën në të cilën fitimi i tatueshëm i ardhshëm është i mjaftueshëm për njësinë ekonomike për të zbritur shumën që rezultojnë nga rimarrja e këtyre diferencave të përkohshme të zbritshme.
 - (ii) njësia ekonomike nuk merr parasysh shumën e tatueshme që krijohet nga diferenca të përkohshme të zbritshme, të cilat pritet të gjenerohen në periudhat e ardhshme, sepse aktivi për tatime të shtyra që krijohet nga këto diferenca të përkohshme të zbritshme do të kërkojë vetë fitim të tatueshëm të ardhshëm në mënyrë që të jetë i përdorshëm;
 - (b) mundësitë e planifikimit tatimor janë të disponueshme për njësinë ekonomike që do të krijojë fitim të tatueshëm në periudhat përkatëse.
- 29A Vlerësimi me çmuarje i fitimit të mundshëm të tatueshëm në të ardhmen mund të përfshijë rikuperimin e disa prej aktiveve të njësive ekonomike për më shumë se vlera e tyre kontabël, nëse ka prova të mjaftueshme se është e mundshme që njësia ekonomike do të mund ta arrijë këtë. Për shembull, kur një aktiv matet me vlerën e drejtë, njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë nëse ka prova të mjaftueshme për të konkluduar se është e mundshme që njësia ekonomike do të rikuperojë aktivin për më

shumë se vlera kontabël neto. Ky mund të jetë rasti, për shembull, kur një njësi ekonomike parashikon të mbajë një instrument borxhi me normë fikse dhe të mbledhë flukse mjeteshe monetare kontraktuale.

...

Data e hyrjes në fuqi

...

98G Njohja e aktiveve për tatime të shtyra për humbjet e perealizuara (Ndryshimet në SNK 12), që është botuar në janar 2016, ndryshoi paragrafin 29 dhe ka shtuar paragrafët 27A, 29A dhe shembullin që pason paragrafin 26. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore nga 1 janar 2017 e në vazhdim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8 *Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet*. Megjithatë, në aplikimin fillestar të këtyre ndryshimeve, ndryshimi (diferenca) në çeljen e kapitalit neto të periudhës më të hershme krahasuese mund të njihet në tepricën e çeljes së fitimeve të pashpërndara (ose në një element tjetër përbërës të kapitaleve të veta, sipas rastit), pa bërë ndarjen e kësaj difference midis çeljes së fitimeve të pashpërndara dhe elementeve të tjera e kapitalit. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë ndryshim ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

Përmirësimet vjetore në SNRF-të
Periudha 2014-2016

Ndryshimet në SNRF1 *Adoptimi për Herë të Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar*

Paragrafët 39L dhe 39T janë ndryshuar, paragrafët 39D, 39F dhe 39AA janë fshirë dhe është shtuar paragrafi 39AD. Teksti i fshirë është vijëzuar në mes dhe teksti i ri është nënvizuar.

Data e hyrjes në fuqi

- ...
- 39D [Fshirë] *Përfashtimi i kufizuar nga Dhënia e Informacioneve Shpjeguese Krahësuese Sipas SNRF 7 për Adoptuesit për Herë të Parë (Ndryshime për SNRF 1), publikuar në Janar 2010, shtoi paragrafin E3. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2010 e në vijim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike e zbaton ndryshimin për një periudhë më të hershme ajo duhet ta paraqesë këtë fakt.*
- ...
- 39F [Fshirë] *Informacione shpjeguese - Transferime të Aktiveve Financiare (Ndryshime në SNRF 7), publikuar në tetor 2010, shtoi paragrafin E4. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2011 e në vijim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike e zbaton ndryshimin për një periudhë më të hershme ajo duhet ta paraqesë këtë fakt.*
- ...
- 39L SNK 19 *Përfitimet e Punonjësve* (siç është ndryshuar në qershor 2011) ndryshoi paragrafin D1, dhe fshiu paragrafët D10 dhe D11 ~~dhe shtoi paragrafin E5~~. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime kur ajo të zbatojë SNK 19 (siç u ndryshua në qershor 2011).
- ...
- 39T *Njësitë ekonomike investuese* (Ndryshime në SNRF 10, SNRF 12, dhe SNK 27), publikuar në Tetor 2012, ndryshuan paragrafët D16, D17 dhe Shtojcën C ~~dhe shtuan një titull dhe paragrafët E6 E7~~. Një njësi ekonomike duhet të aplikojë këto amendamente për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 Janar 2014. Aplikimi më i hershëm i *Njësive Ekonomike Investuese* është i lejuar. Në qoftë se një njësi ekonomike aplikon këto amendamente më herët, ajo duhet të aplikojë të gjitha amendamentet e përfshira në *Njësitë Ekonomike Investuese* në të njëjtën kohë.
- ...
- 39AA [Fshirë] *Përmirësimet vjetore të SNRF-ve Cikli 2012-2014*, publikuar në shtator 2014, shtuan paragrafin E4A. Njësia ekonomike duhet ta zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Janar 2016 ose më pas. Lejohet zbatimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimin për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.
- ...
- 39AD *Përmirësime vjetore të SNRF-ve Cikli 2014-2016*, të publikuara në Dhjetor 2016, ndryshuan paragrafët 39L dhe 39T dhe fshinë paragrafët 39D, 39F, 39AA dhe E3-E7. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore nga 1 janar 2018 e në vazhdim.

Në Shtojcën E janë fshirë paragrafët E3-E7 dhe titujt përkatës.

Shtojca E Përrjashtime afatshkurtra nga SNRF-të

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e kësaj SNRF.

Informacione shpjeguese mbi instrumentet financiare

- E3 [Fshirë] Një miratues për herë të parë mund të zbatojë dispozitat e kalimit në paragrafin 44G të SNRF 7.²
- 2 ~~Paragrafi E3 u shtua si njëdhjetë e Përrjashtimit të Kufizuar nga Dhënia e Informacioneve Shpjeguese Krahase sipas SNRF 7 për Zbatuesit për Herë të Parë (Ndryshime të SNRF 1) publikuar në Janar 2010. Për të shmangur përdorimin e mundshëm të perceptimeve dhe për të siguruar se zbatuesit për herë të parë të mos jenë në një situatë të pafavorshme në krahasim me përgatitësit aktualë të SNRF ve, Bordi vendosi që zbatuesit për herë të parë të lejohen të përdorin të njëjtën dispozitë kalimtare që lejohet për përgatitësit ekzistues të pasqyrave financiare të përgatitura në përputhje me SNRF të që janë përfshirë në Përmirësimi i Dhënies së Informacioneve Shpjeguese për Instrumentet Financiare (Ndryshime të IFRS 7).~~
- E4 [Fshirë] Një miratues për herë të parë mund të zbatojë dispozitat e kalimit në paragrafin 44G të SNRF 7.³
- 30 ~~Paragrafi E4 u shtua si pasojë e Informacionit Shpjegues Transferimet e aktiveve financiare (Ndryshime të SNRF 7) publikuar në tetor 2010. Për të shmangur përdorimin e mundshëm të perceptimeve dhe për të siguruar se zbatuesit për herë të parë të mos jenë në një situatë të pafavorshme në krahasim me përgatitësit aktualë të SNRF ve, Bordi vendosi që zbatuesit për herë të parë të lejohen të përdorin të njëjtën dispozitë kalimtare që lejohet për përgatitësit ekzistues të pasqyrave financiare të përgatitura në përputhje me SNRF të që janë përfshirë në Dhënien e Informacioneve Shpjeguese për Instrumentet Financiare (Ndryshime të IFRS 7).~~
- E4A [Fshirë] Një miratues për herë të parë mund të zbatojë dispozitat kalimtare të paragrafit 44AA të SNRF 7.

Përfitimet e punonjësve

- E5 [Fshirë] Një miratues për herë të parë mund të zbatojë dispozitat e kalimit në paragrafin 173 (b) të SNK 19.

Njësitë ekonomike investuese

- E6 [Fshirë] Një miratues për herë të parë që është shoqëri mëmë do të vlerësojë nëse është një njësi ekonomike investuese, siç përcaktohet në SNRF 10, në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në datën e kalimit në SNRF.
- E7 [Fshirë] Një miratues për herë të parë që është njësi ekonomike investuese siç përcaktohet në SNRF 10, mund të aplikojë dispozitat kalimtare në paragrafët C3C-C3D të SNRF 10 dhe paragrafët 18C-18G të SNK 27 në qoftë se pasqyrat e para financiare të tij sipas SNRF janë për periudhën vjetore që përfundon në ose më parë se 31 Dhjetor 2014. Referencat në këto paragrafë për periudhat vjetore që i paraprijnë menjëherë datës së aplikimit fillestar duhet të lexohen si periudhat vjetore më të hershme të paraqitura. Si pasojë, referencat në këto paragrafë duhet të lexohen si data e kalimit në SNRF.

Ndryshime të SNRF 12 Dhënia e informacionit shpjegues mbi interesat në njësitë e tjera ekonomike

Paragrafi 5A është shtuar.

Objekti

- ...
- 5A Me përjashtim sa përshkruhet në paragrafin B17, kërkesat në këtë SNRF zbatohen për interesat e një njësie ekonomike të renditura në paragrafin 5, që janë klasifikuar (ose të përfshira në një grup të nxjerrë jashtë përdorimit që është klasifikuar) si i mbajtur për shitje ose si operacione jo te vijueshme, në përputhje me SNRF 5 *Aktivitet Afatgjatë të Mbajtura për Shitje dhe veprimtaritë e ndërprera*.
- ...

Në shtojcën B, është shtuar paragrafi B17. Teksti i fshirë është vijëzuar në mes dhe teksti i ri është nënvizuar.

Informacioni përmbledhës financiar për filialet, sipërmarrjet e përbashkëta dhe pjesëmarrjet (paragrafët 12 dhe 21)

- ...
- B17 Kur interesi i një njësie ekonomike në një filial, në një sipërmarrje të përbashkët ose në një pjesëmarrje (ose një pjesë e interesit të saj në një sipërmarrje të përbashkët ose në një pjesëmarrje) është klasifikuar (ose i përfshirë në një grup të nxjerrë jashtë përdorimit që është i klasifikuar) si i mbajtur për shitje në përputhje me SNRF 5 *Aktivitet Afatgjatë të Mbajtura për Shitje dhe veprimtaritë e ndërprera*, nuk është e nevojshme që njësia ekonomike të japë informacion përmbledhës financiar për këtë filial, sipërmarrje të përbashkët ose pjesëmarrje në përputhje me paragrafët B10-B16.

Në shtojcën C është shtuar paragrafi C1D.

Data e hyrjes në fuqi dhe dispozita kalimtare

- ...
- C1D *Përmirësimet vjetore të SNRF-ve Cikli 2014-2016*, të publikuara në Dhjetor 2016, kanë shtuar paragrafin 5A dhe kanë ndryshuar paragrafin B17. Një njësi ekonomike do të aplikojë këto ndryshime në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8 *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*, për periudhat vjetore që fillojnë në 1 janar 2017 e në vazhdim.
- ...

Ndryshimet në

SNK 28 *Investimet në pjesëmarrjet dhe në sipërmarrjet e përbashkëta*

Paragrafët 18 dhe 36A janë ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 45E. Teksti i fshirë është vijëzuar në mes dhe teksti i ri është nënvizuar.

Përgjashtimet nga zbatimi i metodës së kapitalit neto

...

- 18 Kur një investim në një pjesëmarrje ose një sipërmarrje të përbashkët është mbajtur nga, ose mbahet në mënyrë të tërthortë, nëpërmjet një njësie ekonomike që është një organizatë sipërmarrje kapitali ose një fond i përbashkët, njësi besimi dhe njësi ekonomike e ngjashme, përfshirë investimet e lidhura me fondet e sigurimeve, njësia ekonomike mund të zgjedhë të matë këtë investim në këto pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në përputhje me SNRF 9. Një njësi ekonomike do të bëjë këtë zgjedhje veçmas për çdo pjesëmarrje apo sipërmarrje të përbashkët, në njohjen fillestare të pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët.

...

Procedurat e metodës së kapitalit neto

...

- 36A Pavarësisht nga kërkesat e paragrafit 36, nëse një njësi ekonomike që nuk është vetë një njësi ekonomike investuese ka interesa në një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët e cila është njësi ekonomike investuese, gjatë zbatimit të metodës së kapitalit neto njësia mund të zgjedhë të mbajë matjen me vlerën e drejtë të përdorur nga njësia ekonomike investuese pjesëmarrëse ose sipërmarrje e përbashkët për interesat e kësaj të fundit në filiale. Kjo zgjedhje bëhet veçmas për çdo njësi ekonomike investuese në pjesëmarrje apo sipërmarrje të përbashkët, në datën më të vonë në të cilën (a) njësia ekonomike investuese në pjesëmarrje apo sipërmarrje të përbashkët është njohur fillimisht; (b) pjesëmarrja apo sipërmarrja e përbashkët bëhet një njësi ekonomike investuese; dhe (c) njësia ekonomike investuese në pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët bëhet një mëmë për herë të parë.

...

Data e hyrjes në fuqi dhe dispozita kalimtare

...

- 45E Përmirësimet vjetore të SNRF-ve Cikli 2014-2016, të publikuara në Dhjetor 2016, kanë ndryshuar paragrafët 18 dhe 36A. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8 për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2018 e në vijim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

**Zbatimi i SNRF 9 *Instrumentet Financiare*
me SNRF 4 *Kontratat e Sigurimit***

(Ndryshime të SNRF 4)

Ndryshime të SNRF 4 Kontratat e Sigurimit

Është ndryshuar paragrafi 3. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Qëllimi

- ...
- 3 Ky SNRF nuk trajton aspekte të tjera të kontabilitetit nga siguruesit, të tilla si kontabiliteti për aktivet financiare të mbajtura nga siguruesit dhe detyrimet financiare të emetuara nga siguruesit (shih SNK 32 *Instrumentet financiarë: Paraqitja*, SNRF 7 dhe SNRF 9 *Instrumentet financiare*), me përjashtim të:
- (a) paragrafit 20A që lejon siguruesit që plotësojnë kriteret specifike për të zbatuar një përjashtim të përkohshëm nga SNRF 9;
 - (b) paragrafit 35B që lejon siguruesit të aplikojnë një metodë të veçantë për aktive financiare të përcaktuara; dhe
 - (c) në dispozitat kalimtare në paragrafit 45 që lejon siguruesit të riklasifikojnë në rrethana të caktuara disa ose të gjitha aktivet e tyre financiare në mënyrë që aktivet të maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.
- ...

Paragrafi 5 është ndryshuar. Teksti i ri është i nënvizuar.

- ...
- 5 Për lehtësi referimi, ky SNRF përshkruan çdo njësi ekonomike që lëshon një kontratë sigurimi si një sigurues, pavarësisht nëse siguruesi shihet ose jo si një sigurues për qëllime ligjore ose mbikëqyrjeje. Të gjitha referencat në paragrafët 3 (a) -3 (b), 20A-20Q, 35B-35N, 39B-39M dhe 46-49 për një sigurues duhet të lexohen duke iu referuar edhe një emetuesi të një instrumenti financiar që përmban një tipar të pjesëmarrjes së lirë.
- ...

Tituj të rinj janë shtuar poshtë paragrafëve 20, 20K dhe 20N. Janë shtuar paragrafë të rinj 20A dhe 20Q.

Njohja dhe matja

...

Përjashtime të përkohshme nga SNRF 9

- 20A SNRF 9 trajton kontabilitetin për instrumentet financiare dhe zbatohet për periudhat vjetore që fillojnë në 1 janarit 2018 ose më pas. Megjithatë, për një sigurues që plotëson kriteret në paragrafin 20B, ky SNRF jep një përjashtim të përkohshëm që lejon, por nuk kërkon, që siguruesi të zbatojë SNK 39 *Instrumentet Financiarë: Njohja dhe Matja* dhe jo SNRF 9, për periudhat vjetore që fillojnë përpara datës 1 janar 2021. Një sigurues që do të aplikojë përjashtimin e përkohshëm nga SNRF 9 duhet të:

- (a) **përdorë kërkesat e SNRF 9 që janë të nevojshme për të siguruar dhënien e informacioneve shpjeguese të kërkuara në paragrafët 39B-39J të kësaj SNRF-je; dhe**
- (b) **zbatojë të gjitha SNRF-të e tjera të aplikueshme për instrumentet e saj financiare, me përjashtim siç përshkruhet në paragrafët 20A-20Q, 39B-39J dhe 46-47 të kësaj SNRF-je.**
- 20B** Një sigurues mund të zbatojë përjashtimin e përkohshëm nga SNRF 9, nëse, dhe vetëm nëse:
- (a) **ai nuk ka aplikuar më parë ndonjë version të SNRF 9¹, që ndryshojnë vetëm nga kërkesat në paragrafët 5.7.1 (c), 5.7.7-5.7.9, 7.2.14 dhe B5.7.5-B5.7.20 të SNRF 9 për paraqitjen e fitimeve dhe humbjeve në detyrimet financiare të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes; dhe**
- (b) **aktivitetet e tij janë të lidhura kryesisht me sigurimin, siç përshkruhet në paragrafin 20D, në datën e raportimit vjetor, që i paraprin menjëherë datës 1 Prill 2016, ose në një datë të mëvonshme të raportimit vjetor siç është specifikuar në paragrafin 20G.**
- 20C** Një sigurues që zbaton përjashtim e përkohshëm nga SNRF 9 i lejohej të zgjedhë të zbatojë vetëm kërkesat në paragrafët 5.7.1 (c), 5.7.7-5.7.9, 7.2.14 dhe B5.7.5-B5.7.20 të SNRF 9 për paraqitjen e fitimeve dhe humbjeve në pasivet financiare të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes. Nëse një sigurues zgjedh të zbatojë këto kërkesa, ai do të zbatojë dispozitat përkatëse kalimtare në SNRF 9, të japë informacione shpjeguese se ai ka aplikuar këto kërkesa dhe të sigurojë në mënyrë të vazhdueshme dhënien e informacioneve shpjeguese përkatëse të përcaktuara në paragrafët 10-11 të SNRF 7 (të ndryshuar me SNRF 9 (2010)).
- 20D** Aktivitetet e një siguruesi janë të lidhura kryesisht me sigurimin, nëse, dhe vetëm nëse:
- (a) vlera kontabël e detyrimeve që rrjedhin nga kontratat brenda objektit të kësaj SNRF-je, e cila përfshin përbërës të depozitave apo derivativë të përfshirë, që trajohen veçmas nga kontratat e sigurimit që aplikojnë paragrafët 7-12 të kësaj SNRF-je, është e rëndësishme në krahasim me vlerën kontabël neto gjithsej të të gjitha detyrimeve të saj; dhe
- (b) përqindja e shumës totale kontabël të detyrimeve të saj lidhur me sigurimin (shih paragrafin 20E) në lidhje me shumën totale kontabël të të gjitha detyrimeve të saj, është:
- (i) më e madhe se 90 për qind; ose
- (ii) më pak se ose e barabartë me 90 për qind, por më e madhe se 80 për qind, dhe siguruesi nuk do të angazhohet në një aktivitet të rëndësishëm të pa lidhur me sigurimin (shih paragrafin 20F).
- 20E** Për qëllime të aplikimit të paragrafit 20D (b), detyrimet që janë të lidhura me sigurimin përbëhen nga:
- (a) detyrimet që rrjedhin nga kontratat brenda objektit të kësaj SNRF-je, siç përshkruhet në paragrafin 20D (a);
- (b) detyrimet për kontrata investimi jo-derivative të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes që zbaton SNK 39 (duke përfshirë dhe ato të përcaktuara si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes për të cilat siguruesi ka aplikuar kërkesat e SNRF 9 për paraqitjen e fitimeve dhe humbjeve (shih paragrafët 20B (a) dhe 20C)); dhe
- (c) detyrimet që lindin për shkak se siguruesi emeton, ose përbush detyrimet që rrjedhin nga kontratat në pikat (a) dhe (b). Shembuj të detyrimeve të tilla përfshijnë derivativë që përdoren për të zbutur rreziqet që dalin nga këto kontrata dhe nga aktivet që mbështesin ato kontrata, detyrimet përkatëse tatimore, të tilla si detyrimet për tatime të shtyra për diferencat e përkohshme të tatueshme mbi detyrimet që rrjedhin nga këto kontrata, dhe instrumentet e borxhit të emetuara, të cilat janë të përfshira në kapitalin rregullator të siguruesit.
- 20F** Në vlerësimin nëse siguruesi angazhohet në një aktivitet të rëndësishëm të pa lidhur me sigurimin për qëllime të zbatimit të paragrafit 20D (b) (ii), një sigurues duhet të marrë në konsideratë:
- (a) vetëm ato aktivitete nga të cilat mund të fitojë të ardhura dhe bëjë shpenzime; dhe
- (b) faktorët sasiorë ose cilësorë (ose të dy së bashku), duke përfshirë dhe informacion publik disponibël, sic është klasifikimi i sektorëve ekonomike (industrive) që zbatojnë përdoruesit e pasqyrave financiare për siguruesin.
- 20G** Paragrafi 20B (b) kërkon që një njësi ekonomike të vlerësojë nëse ajo kualifikohet për përjashtim të përkohshëm nga SNRF 9 në datën e raportimit vjetor që i paraprin menjëherë datës 1 prill 2016. Pas kësaj date:

- (a) një njësi ekonomike, e kualifikuar më parë për përjashtimin e përkohshëm nga SNRF 9, do të rivlerësojë nëse aktivitetet e saj janë të lidhura kryesisht me sigurimin në një datë të mëpasshme të raportimit vjetor, nëse, dhe vetëm nëse, ka pasur një ndryshim në aktivitetet e njësisë ekonomike, siç përshkruhet në paragrafët 20H-20I, gjatë periudhës vjetore që përfundoi në atë datë.
- (b) një njësi ekonomike, e pa kualifikuar më parë, për përjashtimin e përkohshëm nga SNRF 9, lejohet të rivlerësojë nëse aktivitetet e saj janë të lidhura kryesisht me sigurimin për një datë të mëpasshme të raportimit vjetor, përpara datës 31 dhjetor 2018 nëse, dhe vetëm nëse, ka patur një ndryshim në aktivitetet e njësisë ekonomike, siç përshkruhet në paragrafët 20H-20I, gjatë periudhës vjetore që përfundoi në atë datë.
- 20H Për qëllime të aplikimit të paragrafit 20G, një ndryshim në aktivitetet e një njësie ekonomike është një ndryshim që:
- (a) përcaktohet nga drejtuesit e lartë të njësisë ekonomike, si rezultat i ndryshimeve të jashtme ose të brendshme;
- (b) është i rëndësishëm për operacionet e njësisë ekonomike; dhe
- (c) është i provueshëm dhe i dukshëm për palët e jashtme.
- Prandaj, një ndryshim i tillë ndodh vetëm kur njësia ekonomike fillon ose ndërpret kryerjen e një aktiviteti që është i rëndësishëm për operacionet e saj, ose në mënyrë të konsiderueshme ndryshon madhësinë e një prej aktiviteve të saj; për shembull, kur njësia ekonomike ka blerë, ka shitur ose ka ndërprerë një linjë të biznesit.
- 20I Një ndryshim në aktivitetet e një njësie ekonomike, siç përshkruhet në paragrafin 20H, pritet të jetë shumë i rrallë. Ndryshimet e përmendura më poshtë nuk janë ndryshime në aktivitetet e një njësie ekonomike për qëllime të aplikimit të paragrafit 20G:
- (a) një ndryshim në strukturën e financimit të njësisë ekonomike, i cili në vetvete nuk ndikon aktivitetet nga të cilat njësia ekonomike përfiton të ardhura dhe kryen shpenzime.
- (b) plani i njësisë ekonomike për të shitur një linjë të biznesit, edhe në qoftë se aktivet dhe detyrimet janë klasifikuar si të mbajtura për shitje që aplikon SNRF 5 *Aktivet Afatgjata që Mbahen për Shitje dhe Veprimtaritë e Ndërprera*. Një plan për të shitur një linjë të biznesit mund të ndryshojë aktivitetet e njësisë ekonomike dhe të çojë në një rivlerësim në të ardhmen, por ende nuk ka ndikuar në detyrimet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar.
- 20J Nëse një njësi ekonomike, si rezultat i rivlerësimit, nuk kualifikohet për me tej për një përjashtim të përkohshëm nga SNRF 9 (shih paragrafin 20G (a)), atëherë njësia ekonomike lejohet të vazhdojë të aplikojë përjashtimin e përkohshëm nga SNRF 9 vetëm deri në fund të periudhës vjetore raportuese që fillon menjëherë pas këtij rivlerësimi. Sidoqoftë, një njësi ekonomike duhet të zbatojë SNRF 9 për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2021 e në vijim. Për shembull, në qoftë se një njësi ekonomike duke aplikuar paragrafin 20G (a) më 31 dhjetor 2018 (fundi i periudhës së saj vjetore), përcakton se ajo nuk kualifikohet për me tej për përjashtim të përkohshëm nga SNRF 9, atëherë njësia ekonomike lejohet të vazhdojë të zbatojë përjashtim të përkohshëm nga SNRF 9 vetëm deri më 31 dhjetor 2019.
- 20K Një sigures i cili ka zgjedhur më parë të aplikojë përjashtimin e përkohshëm nga SNRF 9 në fillim të çdo periudhe të mëvonshme vjetore mund të zgjedhë të zbatojë SNRF 9 në mënyrë të parevokueshme.

Adoptues (Miratues) për herë të parë

- 20L Një adoptues për herë të parë, siç përcaktohet në SNRF 1 *Adoptimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar*, mund të aplikojë përjashtimin e përkohshëm nga SNRF 9 të përshkruar në paragrafin 20A nëse, dhe vetëm nëse, ai plotëson kriteret e përshkruara në paragrafin 20B. Për zbatimin e paragrafit 20B (b), adoptuesi për herë të parë do të përdorë vlerat kontabël të përcaktuara duke aplikuar SNRF-të në datën e përcaktuar në këtë paragraf.
- 20M SNRF 1 përmban kërkesat dhe përjashtimet të aplikueshme për një adoptues për herë të parë. Këto kërkesa dhe përjashtime (për shembull, paragrafët D16-D17 të SNRF 1) nuk i përjashtojnë kërkesat në paragrafët 20A-20Q dhe 39B-39J të kësaj SNRF-je. Për shembull, kërkesat dhe përjashtimet në SNRF 1 nuk e përjashtojnë kërkesën që një adoptues për herë të parë do të plotësojë kriteret e përcaktuara në paragrafin 20L për të aplikuar përjashtim të përkohshëm nga SNRF 9.
- 20N Një adoptues për herë të parë që jep informacion shpjegues për informacionin e kërkuar nga paragrafët 39B-39J do të përdorë kërkesat dhe përjashtimet e SNRF 1 të cilat janë të përshtatshme për të bërë vlerësimet e nevojshme për këto informacione shpjeguese.

Përrjashtim i përkohshëm nga kërkesat e veçanta të SNK 28

- 20O Paragrafët 35-36 të SNK 28 *Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta*, kërkojnë që një njësi ekonomike të zbatojë politika kontabël uniforme kur përdor metodën e kapitalit neto. Megjithatë, për periudhat që fillojnë para datës 1 janar 2021, një njësi ekonomike i lejohet, por nuk i kërkohet, të mbajë të njëjtat politika përkatëse të kontabilitetit të zbatuara nga pjesëmarrjet ose sipërmarrjet e përbashkëta si më poshtë:
- (a) njësi ekonomike aplikon SNRF 9, por pjesëmarrja ose sipërmarrja e përbashkët aplikon përrjashtim të përkohshëm nga SNRF 9; ose
 - (b) njësi ekonomike aplikon përrjashtimin e përkohshëm nga SNRF 9, por pjesëmarrja ose sipërmarrja e përbashkët zbaton SNRF 9.
- 20P Kur një njësi ekonomike përdor metodën e kapitalit neto për të llogaritur investimin e saj në një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët:
- (a) nëse SNRF 9 ka qene aplikuar më herët në pasqyrat financiare që kanë përdorur më parë metodën e kapitalit neto në atë pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët (pasi janë reflektuar ndryshimet e bëra nga njësi ekonomike), atëherë SNRF 9 do të vazhdojnë të zbatohet.
 - (b) nëse përrjashtimi i përkohshëm nga SNRF 9 është aplikuar më parë në pasqyrat financiare që kanë përdorur më parë metodën e kapitalit neto në atë pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët (pasi janë reflektuar ndryshimet e bëra nga njësi ekonomike), atëherë SNRF 9 mund të zbatohet më vonë.
- 20Q Një njësi ekonomike mund të zbatojë paragrafët 20O dhe 20P (b) veçmas për çdo pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët.

Janë shtuar paragrafët e rinj 35A - 35N, 39B-39M dhe 46-49. Janë shtuar titujt e rinj nën paragrafët 35A, 35K, 35M, 39A, 39J, 45 dhe 47.

Tiparet e pjesëmarrjes së lirë në instrumentet financiare

- 35A Përrjashtimet e përkohshme në paragrafët 20A, 20L dhe 20O dhe metoda e veçantë në paragrafin 35B janë gjithashtu në dispozicion për një emetues të një instrumenti financiar që përmban një tipar të pjesëmarrjes së lirë. Prandaj, të gjitha referencat në paragrafët 3 (a) -3 (b), 20A-20Q, 35B-35N, 39B-39M dhe 46-49 për një sigurues duhet të lexohen sikur t'i referoheshin edhe një emetuesi të një instrumenti financiar që përmban një tipar pjesëmarrjeje të lirë.

Paraqitja**Metoda e paraqitjes e veçantë**

- 35B Një sigurues lejohet, por nuk i kërkohet, të zbatojë metodën e veçantë për aktiveve financiare të përcaktuara si të tilla. Një sigurues që zbaton metodën e veçantë do të:
- (a) të riklasifikojë midis fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse një shumë që rezulton në fitim ose humbje në fund të periudhës raportuese për aktivet financiare të përcaktuara të tilla, njëllëj sikur siguruesi të kishte zbatuar SNK 39 për të njëjtat aktivet financiare të përcaktuara. Prandaj, shuma e riklasifikuar është e barabartë me diferencën midis:
 - (i) shumës së raportuar në fitim ose humbje për aktivet financiare të përcaktuara të tilla nga aplikimi i SNRF 9; dhe
 - (ii) shumës që do të ishte raportuar në fitim ose humbje për aktivet financiare të përcaktuara të tilla, në qoftë se siguruesi do të kishte aplikuar SNK 39.
 - (b) të zbatojë të gjitha SNRF-të e tjera të zbatueshme, për instrumentet e tij financiare, me përrjashtim siç përshkruhet në paragrafët 35B-35N, 39K-39M dhe 48-49 të kësaj SNRF-je.

- 35C** Një sigurues mund të zgjedhë të aplikojë metodën e veçantë të përshkruar në paragrafin 35B vetëm kur ai zbaton për herë të parë SNRF 9, duke përfshirë këtu edhe rastin kur zbaton SNRF 9 për herë të parë, pasi me herët ka zbatuar:
- (a) përjashtimin e përkohshëm nga SNRF 9, të përshkruar në paragrafin 20A; ose
 - (b) vetëm kërkesat për paraqitjen e fitimeve dhe humbjeve në detyrimet financiare të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, që jepen në paragrafët 5.7.1 (c), 5.7.7-5.7.9, 7.2.14 dhe B5.7.5-B5.7.20 të SNRF 9 për paraqitjen e.
- 35D** Një sigurues do të paraqesë shumën e riklasifikuar midis fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse duke aplikuar metodën e veçantë:
- (a) në fitim ose humbje si një nënzë të veçantë; dhe
 - (b) në të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse, si një përbërës të veçantë të të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse.
- 35E** Një aktiv financiar përcaktohet si i pranueshëm për metodën e veçantë, nëse, dhe vetëm nëse, plotësohen kriteret e mëposhtme:
- (a) ai është matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes duke aplikuar SNRF 9, por nuk do të ishte i matur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në tërësinë e tij, po të zbatohet SNK 39; dhe
 - (b) ai nuk është mbajtur në lidhje me një aktivitet që nuk ka të bëjë me kontratat brenda objektit të kësaj SNRF-je. Shembuj të aktiveve financiare që nuk do të jenë të pranueshme për metodën e veçantë janë ato aktive të mbajtura në lidhje me aktivitetet bankare ose aktivet financiare të mbajtura në fonde që kanë të bëjnë me kontratat e investimeve që janë jashtë objektit të kësaj SNRF-je.
- 35F** Një sigurues mund të përcaktojë një aktiv financiar të pranueshëm për metodën e veçantë në momentin kur ai zgjedh të zbatojë metodën e veçantë (shih paragrafin 35C). Më pas, ai mund të përcaktojë një aktiv financiar të pranueshëm për metodën e veçantë atëherë, dhe vetëm atëherë kur:
- (a) ky aktiv njihet fillimisht si i tillë; ose
 - (b) ky aktiv sapo plotëson kriterin në paragrafin 35E (b) por nuk e ka plotësuar këtë kriter më parë.
- 35G** Një sigurues lejohet të përcaktojë aktivet financiare që janë të pranueshëm për qasjen e veçantë duke zbatuar paragrafin 35F, rast pas rasti për çdo instrument.
- 35H** Kur është e përshtatshme, për qëllime të zbatimit të metodës së veçantë për një aktiv financiar te sapo përcaktuar si i pranueshëm për metodën e veçantë duke zbatuar paragrafin 35F (b):
- (a) vlera e drejtë në datën e përcaktimit, do të jetë vlera e tij e re kontabël sipas kostos së amortizuar; dhe
 - (b) norma e interesit efektiv duhet të përcaktohet bazuar në vlerën e drejtë në datën e përcaktimit.
- 35I** Një njësi ekonomike do të vazhdojë të zbatojë metodën e veçantë të një aktivit financiar të caktuar derisa ai aktiv financiar të çregjistrohet. Megjithatë, një njësi ekonomike:
- (a) do të heqë nga përcaktimi si i pranueshëm për metodën e veçantë një aktiv financiar kur aktiviteti financiar nuk plotëson më kriterin në paragrafin 35E (b). Për shembull, një aktiv financiar nuk do të plotësonte më këtë kriter, kur një njësi ekonomike transferon këtë aktiv i cili mbahet për llogari të aktivitetit të tij bankare ose kur njësi ekonomike humbet statusin e të qenit një sigurues.
 - (b) në fillim të çdo periudhe vjetore, mund të heqë dorë nga zbatimi i metodës së veçantë për të gjitha aktivet financiare të përcaktuara si të tilla. Një njësi ekonomike që zgjedh për të hequr dorë nga zbatimi i metodës së veçantë do të zbatojë SNK 8 për të paraqitur efektet e ndryshimit të politikave kontabël.
- 35J** Kur një njësi ekonomike heq nga përcaktimi një aktiv financiar duke zbatuar paragrafin 35I (a), ajo do ta riklasifikojë çdo tepriçë që i përket këtij aktiv nga të ardhura të tjera gjithpërfshirëse të akumuluar në fitim ose humbje si një rregullim riklasifikues (shih SNK 1).
- 35K** Nëse një njësi ekonomike ndalon së përdoruri metodën e veçantë duke zgjedhur të zbatojë paragrafin 35I (b) ose për shkak se nuk është më një sigurues, ajo nuk duhet të aplikojë më pas metodën e veçantë. Një sigurues që ka zgjedhur të zbatojë metodën e veçantë (shih paragrafin 35C), por nuk ka aktive financiare që plotësojnë kushtet si të tilla, (shih paragrafin 35E) mund të aplikojnë metoden e veçantë më pas, kur ajo do të ketë aktive financiare të tilla.

Ndërveprimi me kërkesat e tjera

- 35L Paragrafi 30 i kësaj SNRF-je lejon një praktikë që ndonjëherë quhet si 'kontabiliteti hije'. Nëse një sigurues zbaton metodën e veçantë, kontabiliteti hije mund të jetë i zbatueshëm.
- 35M Riklasifikimi i një shume midis fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duke aplikuar paragrafin 35B mund të ketë efekte pasuese në tatimin mbi të ardhurat duke përfshirë edhe shumat e tjera në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse. Një sigurues do të zbatojë SNRF-të përkatëse, si për shembull SNK 12 *Tatimet mbi të ardhura*, për të përcaktuar ndonjë efekt të tillë pasues.

Adoptuesi për herë të parë

- 35N Në qoftë se një adoptues për herë të parë zgjedh të zbatojë metodën e veçantë, ai do të riparaqesë informacionin krahasues për të reflektuar metodën e veçantë nëse, dhe vetëm nëse, ai riparaqet informacionin krahasues në përputhje me SNRF 9 (shih paragrafët E1-E2 të SNRF 1).

...

Dhënia e informacioneve shpjeguese

Dhënia e informacioneve shpjeguese në lidhje me përjashtimin e përkohshëm nga SNRF 9

- 39B** Një sigurues që zgjedh të zbatojë përjashtimin e përkohshëm nga SNRF 9 do të japë informacion shpjegues për t'ju mundësuar përdoruesve të pasqyrave financiare:
- (a) të kuptojnë se si siguruesi është kualifikuar për përjashtimin e përkohshëm; dhe
 - (b) të krahasojnë siguruesit që aplikojnë përjashtimin e përkohshëm me njësitë ekonomike që aplikojnë SNRF 9.
- 39C** Për të qenë përputhje me paragrafin 39B(a), një sigurues duhet të japë informacion shpjegues për faktin se ai aplikon përjashtimin e përkohshëm nga SNRF 9 dhe se si siguruesi ka zgjedhur datën e specifikuar në paragrafin 20B(b) që e kualifikon atë për përjashtimin e përkohshëm nga SNRF 9, duke përfshirë:
- (a) nëse vlera kontabël e detyrimeve që rrjedhin nga kontratat brenda objektit të kësaj SNRF-je (d.m.th ato detyrime të përshkruara në paragrafin 20E (a)) ishte më pak ose e barabartë me 90 për qind të shumës totale kontabël të të gjitha detyrimeve të tij, natyrën dhe vlerën kontabël të detyrimeve të lidhura me sigurimin, të cilat nuk janë detyrime që rrjedhin nga kontratat brenda objektit të kësaj SNRF-je (d.m.th ato detyrime të përshkruara në paragrafët 20E (b) dhe 20E (c));
 - (b) nëse përqindja e shumës totale kontabël të detyrimeve të tij, lidhur me sigurimin në krahasim me vlerën kontabël neto gjithsej të të gjitha detyrimeve të tij, ishte më pak se ose e barabartë me 90 për qind, por më e madhe se 80 për qind, mënyrën si siguruesi ka përcaktuar se ai nuk është i angazhuar në një aktivitet të rëndësishëm pa lidhje me sigurimin, duke përfshirë edhe se çfarë informacioni është marrë në konsideratë; dhe
 - (c) nëse siguruesi kualifikohet për përjashtimin e përkohshëm nga SNRF 9 në bazë të rivlerësimit duke zbatuar paragrafin 20G (b):
 - (i) arsyen e rivlerësimit.
 - (ii) datën në të cilën ka ndodhur ndryshimi i rëndësishëm në aktivitetet e tij; dhe
 - (iii) një shpjegim të detajuar të ndryshimit të aktiviteteve të tij dhe një përshkrim cilësor të efektit të atij ndryshimi në pasqyrat financiare të siguruesit.
- 39D** Në zbatim të paragrafit 20G (a), nëse një njësi ekonomike arrin në përfundimin se aktivitetet e saj nuk janë më të lidhura kryesisht me sigurimin, ajo duhet të japë informacionin e mëposhtëm në çdo periudhë raportuese para se të fillojë të zbatojë SNRF 9:
- (a) faktin se ajo nuk kualifikohet për përjashtimin e përkohshëm nga SNRF 9;
 - (b) datën në të cilën ka ndodhur ndryshimi i rëndësishëm në aktivitetet e saj; dhe
 - (c) një shpjegim të detajuar të ndryshimit të aktiviteteve të saj dhe një përshkrim cilësor të efektit të këtij ndryshimi në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike.
- 39E** Në përputhje me paragrafin 39B(b), një sigurues duhet të japë informacion shpjegues për vlerën e drejtë në fund të periudhës raportuese dhe shumën e ndryshimit në vlerën e drejtë gjatë kësaj periudhe për të dy grupet e mëposhtme të aktiveve financiare veçmas:
- (a) aktivet financiare me kushte kontraktuale që, në datat e specifikuara, ndikojnë në flukset e mjeteve monetare vetëm me anë të pagesave të principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar (p.sh. aktivet financiare që plotësojnë kushtin në paragrafin 4.1.2 (b) dhe 4.1.2A (b) të SNRF 9), duke përjashtuar çdo aktiv financiar që plotëson përkufizimin si të mbajtura për tregtim në SNRF 9, ose që është menaxhuar dhe performanca e të cilit është vlerësuar në bazë të vlerës së drejtë (shih paragrafin B4.1.6 të SNRF 9).
 - (b) të gjitha aktivet financiare përveç atyre të specifikuara në paragrafin 39E (a); që është, çdo aktiv financiar:
 - (i) me kushte kontraktuale që nuk sjellin flukse monetare në data të përcaktuara që kanë të bëjnë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar;

ZBATIMI I SNRF 9 INSTRUMENTET FINANCIARE ME SNRF 4 KONTRATAT E SIGURIMIT

- (ii) që plotëson përkufizimin si të mbajtura për tregtim në SNRF 9; ose
 - (iii) që menaxhohet dhe performanca e të cilit është vlerësuar në bazë të vlerës së drejtë.
- 39F Kur siguroesi jep informacione shpjeguese për informacionin në paragrafin 39E, ai:
- (a) mund të gjykojë se matja e vlerës kontabël të aktivitetit financiar sipas SNK 39 të jetë një përafrim i arsyeshëm i vlerës së tij të drejtë, nëse siguroesi nuk është i detyruar të japë informacion shpjegues për vlerën e drejtë sipas paragrafit 29 (a) të SNRF 7 (p.sh. llogari të arkëtueshme tregtare afat shkurtër); dhe
 - (b) do të marrë parasysh nivelin e detajeve të nevojshme për t'ju mundësuar përdoruesve të pasqyrave financiare të kuptojnë karakteristikat e aktiveve financiare.
- 39G Për të qënë në përputhje me paragrafin 39B(b), një siguroesi do të japë informacione shpjeguese në lidhje me ekspozimin e rrezikut të konsiderueshëm të kredisë, duke përfshirë edhe përqendrimet të rëndësishme të rrezikut të kredisë, si një rrezik i natyrshëm për aktivet financiare të përshkruara në paragrafin 39E (a). Minimalisht, për keto aktive financiare, në fund të periudhës raportuese, një siguroesi do të japë informacionin shpjegues të mëposhtëm:
- (a) klasat sipas vlerësimit të rrezikut të kredisë siç përcaktohet në SNRF 7, vlerat kontabël duke zbatuar SNK 39 (në rastin e aktiveve financiare të matura me koston e amortizuar, para rregullimit për provizionet e zhvlerësimit).
 - (b) për aktivet financiare të përshkruara në paragrafin 39E (a) që nuk kanë rrezik të ulët të kredisë në fund të periudhës raportuese, vlerën e drejtë dhe vlerën kontabël duke zbatuar SNK 39 (në rastin e aktiveve financiare të matura me koston e amortizuar, para rregullimit për provizionet e zhvlerësimit). Për qëllimet e dhënies së informacioneve shpjeguese për këtë rast, paragrafi B5.5.22 i SNRF 9 parashikon kërkesat përkatëse për vlerësimin nëse rreziku i kredisë për një instrument financiar është konsideruar i ulët.
- 39H Për të qënë në përputhje me paragrafin 39B(b), një siguroesi do të japë informacion shpjegues për përdoruesit e pasqyrave financiare se ku ata mund të marrin ndonjë informacion të hapur për publikun rreth SNRF 9 që lidhet me një njësi ekonomike brenda grupit dhe që nuk është paraqitur në pasqyrat financiare të konsoliduara të grupit për periudhën përkatëse raportuese. Për shembull, të tilla informacione për SNRF 9 mund të merren nga pasqyrat financiare individuale ose të veçanta, të disponueshme publikisht, të një njësie ekonomike brenda grupit që ka aplikuar SNRF 9.
- 39I Nëse një njësi ekonomike që ka zgjedhur të zbatojë përjashtimin në paragrafin 20O për kërkesat e veçanta të SNK 28, ajo duhet të japë informacionet shpjeguese për këtë fakt.
- 39J Nëse një njësi ekonomike ka zbatuar përjashtim të përkohshëm nga SNRF 9 për investimin e saj në një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët duke përdorur metodën e kapitalit neto (për shembull, shih paragrafin 20O (a)), përveç informacionit të kërkuar nga SNRF 12 *Dhënia e informacionit shpjegues mbi interesat në njësitë e tjera ekonomike*, njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues si më poshtë:
- (a) informacionin e përshkruar në paragrafët 39B-39H për çdo pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët që është materiale për njësinë ekonomike. Shumat që do të jepen këtu duhet të jenë ato të përfshira në pasqyrat financiare sipas SNRF-ve, të pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët, pasi të jenë reflektuar ndryshimet e bëra nga njësi ekonomike kur përdoret metoda e kapitalit neto (shih paragrafin B14(a) të SNRF 12), dhe jo shumat proporcionale që i përkasin njësisë ekonomike.
 - (b) informacionin sasior të përshkruar nga paragrafët 39B-39H në total për të gjithë pjesëmarrjet ose sipërmarrjet e përbashkëta që janë jo materiale individualisht. Shumat totale:
 - (i) të shpjeguara do të jenë pjese e këtyre shumave që i përkasin njësisë ekonomike; dhe
 - (ii) për pjesëmarrjet shumat do të shpjegohen (paraqiten) veçmas nga shumat totale të shpjeguara (paraqitura) për sipërmarrjet e përbashkëta.

Dhënia e informacioneve shpjeguese në lidhje me metodën e veçantë të paraqitjes

- 39K Një siguroesi që zbaton metodën e veçantë do të japë informacion shpjegues për t'ju mundësuar përdoruesve të pasqyrave financiare të kuptojnë:
- (a) se si llogaritet shuma totale e riklasifikuar midis fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse në periudhën raportuese; dhe
 - (b) efektin i këtij riklasifikimi në pasqyrat financiare.

- 39L Për të qenë në pajtim me paragrafin 39K, një sigures do të japë informacion shpjegues për:
- (a) faktin se ai ka aplikuar metodën e veçantë;
 - (b) vlerën kontabël në fund të periudhës së raportimit të aktiveve financiare, për të cilat siguresi aplikon metodën e veçantë sipas klasës së aktivitetit financiar;
 - (c) bazat për përcaktimin e aktiveve financiare për metodën e veçantë, duke përfshirë një shpjegim për secilën nga aktivet financiare të përcaktuara që janë mbajtur jashtë njësisë ekonomike ligjore që lëshon kontrata brenda objektit të kësaj SNRF-je;
 - (d) një shpjegim të shumës totale që riklasifikohet midis fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse në periudhën raportuese, në një mënyrë që mundëson përdoruesit e pasqyrave financiare të kuptojnë se si është përcaktuar shumja, duke përfshirë:
 - (i) shumën e raportuar në fitim ose humbje për aktivet e përcaktuara financiare sipas zbatimit të SNRF 9; dhe
 - (ii) shumën që do të ishte raportuar në fitim ose humbje për aktivet financiare të përcaktuara në qoftë se siguresi do të kishte zbatuar SNK 39.
 - (e) efektin e riklasifikimit të përshkruar në paragrafët 35B dhe 35M në secilin zë të prekur në fitim ose humbje; dhe
 - (f) nëse gjatë periudhës raportuese siguresi ka ndryshuar përcaktimin e aktiveve financiare:
 - (i) shumën e riklasifikuar midis fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse në periudhën raportuese në lidhje me aktivet financiare të reja të përcaktuara sipas zbatimit të metodës së veçantë (shih paragrafin 35F (b));
 - (ii) shumën që do të ishte riklasifikuar midis fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse në periudhën e raportimit, nëse aktivet financiare nuk do ishin të hequr nga përcaktimi (shih paragrafin 35I (a)); dhe
 - (iii) shumën e riklasifikuar në periudhën raportuese në fitim ose humbje nga të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse të akumuluar për aktivet financiare që janë hequr nga përcaktimi (shih paragrafin 35J).
- 39M Nëse një njësi ekonomike ka zbatuar metodën e veçantë për investimin e saj në një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët duke përdorur metodën e kapitalit neto, njësia ekonomike, përveç informacionit të kërkuar nga SNRF 12, duhet të japë informacion shpjegues si më poshtë:
- (a) informacionin e përshkruar në paragrafët 39K-39L për çdo pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët që është materiale për njësinë ekonomike. Shumat që do jepen këtu duhet të jenë ato të përfshira në pasqyrat financiare sipas SNRF-ve, të pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët, pasi të jenë reflektuar ndryshimet e bëra nga njësia ekonomike kur përdoret metoda e kapitalit neto (shih paragrafin B14(a) të SNRF 12), dhe jo shumat proporcionale që i përkasin njësisë ekonomike.
 - (b) informacionin sasior të përshkruar nga paragrafët 39K-39L(d) dhe 39L(f), dhe efektin e riklasifikimit të përshkruar në paragrafin 35B në fitim ose humbje dhe të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse në total për të gjithë pjesëmarrjet ose sipërmarrjet të përbashkëta që janë individualisht jo materiale. Shumat totale:
 - (i) të shpjguara do jenë pjesa e këtyre shumave që i përket njësisë ekonomike; dhe
 - (ii) për pjesëmarrjet, do të shpjgohen (paraqiten) veçmas nga shumat agregate të shpjguara për sipërmarrjet e përbashkëta.

...

Data e hyrjes në fuqi dhe dispozita kalimtare

...

Zbatimi i SNRF 4 dhe SNRF 9

Përfshirje të përkohshme nga SNRF 9

- 46 *Zbatimi SNRF 9* Instrumentet Financiare me *SNRF 4* Kontratat e sigurimit (Ndryshimet në SNRF 4), publikuar në shtator të vitit 2016, ka ndryshuar paragrafët 3 dhe 5, dhe ka shtuar paragrafët 20A-20Q, 35A dhe 39B-39J dhe titujt pas paragrafëve 20, 20K, 20N dhe 39A. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime, të cilat lejojnë siguruesit që plotësojnë kriteret specifike për të aplikuar një përfshirje të përkohshme nga SNRF 9, për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janarit 2018 dhe më pas.
- 47 Një njësi ekonomike që jep informacion shpjegues për informacionin e kërkuar nga paragrafët 39B-39J do të përdorë dispozitat kalimtare të SNRF 9, të cilat janë të përshtatshme për të bërë vlerësimet e nevojshme për këto informacione shpjeguese. Data e fillimit të zbatimit për këtë qëllim do të jetë fillimi i periudhës së parë vjetore që nis më 1 janar 2018 ose më pas.

Metoda e veçantë e paraqitjes

- 48 *Zbatimi SNRF 9* Instrumentet Financiare me *SNRF 4* Kontratat e sigurimit (Ndryshimet në SNRF 4), publikuar në shtator të vitit 2016, ka ndryshuar paragrafët 3 dhe 5, dhe ka shtuar paragrafët 35A-35N, dhe 39K-39M dhe titujt pas paragrafëve 35A, 35K, 35M dhe 39J. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime, të cilat lejojnë siguruesit për të aplikuar metodën e veçantë për aktivet financiare të përcaktuara, kur ai zbaton për herë të parë SNRF 9 (shih paragrafin 35c).
- 49 Një njësi ekonomike që zgjedh të zbatojë metodën e veçantë do të:
- (a) zbatojë këtë metodë në retrospektivë për aktivet financiare të përcaktuara përgjatë kalimit në SNRF 9. Në përputhje me rrethanat, për shembull, njësi ekonomike do të njohë si një rregullim në tepërin e çeljes së të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse të akumuluar, një shumë të barabartë me diferencën midis vlerës së drejtë të aktiveve financiare të përcaktuara sipas zbatimit të SNRF 9 dhe vlerës kontabël të tyre të përcaktuar sipas zbatimit të SNK 39.
 - (b) riparaqesë informacion krahasues për të reflektuar metodën e veçantë nëse, dhe vetëm nëse, njësi ekonomike riparaqet informacion krahasues duke zbatuar SNRF 9.

Iniciativë për Dhënie Informacionesh Shpjeguese
(Ndryshime në SNK 7)

Ndryshime të SNK 7 *Flukset e mjeteve monetare*

Janë shtuar paragrafët 44A-44E dhe titujt përkatës. Është shtuar edhe paragrafi 60.

Ndryshime në detyrimet që rrjedhin nga veprimtaritë financiare

- 44A** Një njësi ekonomike do të japë informacione shpjeguese që ju mundësojnë përdoruesve të pasqyrave financiare të vlerësojnë ndryshimet në detyrimet që rrjedhin nga veprimtaritë financiare, duke përfshirë edhe ndryshimet që rrjedhin nga flukset e mjeteve monetare dhe ndryshimet jo monetare.
- 44B** Në përpjekje për të përmbushur masën e nevojshme të kërkesave në paragrafin 44A, një njësi ekonomike do të japë informacione shpjeguese për ndryshimet e mëposhtme në detyrimet që rrjedhin nga veprimtaritë financiare:
- (a) ndryshimet e flukseve të mjeteve monetare nga veprimtaria financiare;
 - (b) ndryshimet që rrjedhin nga marrja ose humbja e kontrollit të filialeve ose bizneseve të tjera;
 - (c) efektin e ndryshimeve të kursit të këmbimit valutor.
 - (d) ndryshimet në vlerën e drejtë; dhe
 - (e) ndryshime të tjera.
- 44C** Detyrimet që rrjedhin nga veprimtaritë financiare janë detyrimet për të cilat flukset e mjeteve monetare ishin klasifikuar ose flukset e mjeteve monetare të ardhshme do të klasifikohen në pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare si flukse monetare nga veprimtaritë financiare. Përveç kësaj, kërkesa për dhënie informacionesh shpjeguese në paragrafin 44A zbatohet gjithashtu, për ndryshimet në aktivet financiare (për shembull, aktivet që mbulojnë detyrimet që rrjedhin nga veprimtaritë financiare) nëse flukset e mjeteve monetare nga këto aktive financiare janë përfshirë ose do të përfshihen në flukset e mjeteve monetare të ardhshme nga veprimtaritë financiare.
- 44D** Një mënyrë për të përmbushur kërkesën për dhënie informacionesh shpjeguese në paragrafin 44A është kryerja e një rakordimi midis tepicës të çeljes dhe mbylljes në pasqyrën e pozicionit financiar për detyrimet që rrjedhin nga veprimtaritë financiare, duke përfshirë ndryshimet e identifikuara në paragrafin 44B. Kur një njësi ekonomike bën këtë rakordim të tillë, ajo duhet të sigurojë informacione të mjaftueshme për t'ju mundësuar përdoruesve të pasqyrave financiare të lidhin zërat e përfshirë në këtë rakordim me pasqyrën e pozicionit financiar dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare.
- 44E** Nëse një njësi ekonomike jep informacionet shpjeguese të kërkuara nga paragrafi 44A në kombinim me informacionet shpjeguese për ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e tjera, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për ndryshimet në detyrimet që rrjedhin nga veprimtaritë financiare veçmas nga ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e tjera.

Data e hyrjes në fuqi

60

...

Iniciativa mbi Dhënie Informacionesh Shpjeguese (Ndryshime në SNK 7), e publikuar në janar 2016, ka shtuar paragrafët 44A-44E. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që nisin nga data 1 janar 2017 e në vazhdim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Kur njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për herë të parë, nuk kërkohet të japë informacion krahasues për periudhat e mëparshme.

KIRNF[®] Interpretimi 22

Transaksionet dhe paradhënia në monedhë të huaj

KIRNF Interpretimi 22

Transaksionet dhe paradhënia në monedhë të huaj

Referencat

- *Kuadri Konceptual për Raportimin Financiar*
- SNK 8 *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*
- SNK 21 *Efektet e Ndryshimeve në Kurset e Këmbimit në Monedhat e Huaja*

Konteksti

- 1 Paragrafi 21 i SNK 21 *Efektet e ndryshimeve në kurset e këmbimit* kërkon që një njësi ekonomike të regjistrojë një transaksion në monedhë të huaj, në momentin e njohjes fillestare, në monedhën e saj funksionale duke shumëzuar shumën në valutë të huaj me kursin e këmbimit të çastit midis monedhës funksionale dhe monedhës së huaj (kursi i këmbimit) në datën e transaksionit. Paragrafi 22 i SNK 21 thotë se data e transaksionit është data në të cilën transaksioni fillimisht kualifikohet për njohje në përputhje me Standardet e SNRF-ve (Standardet).
- 2 Kur një njësi ekonomike paguan ose merr një shumë paradhënie në një monedhë të huaj, ajo në përgjithësi njeh një aktiv jo-monetar ose një detyrim jo-monetar¹ përpara se të njohë aktivin, shpenzimin ose të ardhurën që ka lidhje me të. Aktivin, shpenzimin ose të ardhurën përkatëse (ose një pjesë e saj) është shuma e njohur sipas zbatimit të Standardeve përkatëse, gjë që rezulton në çregjistrimin e aktivit jo-monetar ose detyrimit jo-monetar të krijuar nga shuma paradhënie.
- 3 Komiteti i Interpretimeve të SNRF-ve (Komiteti i Interpretimeve) fillimisht mori një pyetje ku kërkohej se si duhet të përcaktohet "data e transaksionit" duke zbatuar paragrafët 21-22 të SNK 21 kur njihen të ardhurat. Pyetja në mënyrë të veçantë adresonte rrethanat në të cilat një njësi ekonomike njeh një detyrim jo-monetar që rrjedh nga marrja e një shume paradhënie përpara se të njohë të ardhurat që kanë lidhje me të. Në diskutimin e çështjes, Komiteti i Interpretimeve vuri në dukje se marrja ose pagesa e shumës paradhënie në një monedhë të huaj nuk kufizohet nga transaksionet e të ardhurave. Prandaj, Komiteti i Interpretimeve vendosi të sqarojë datën e transaksionit me qëllim që të përcaktonte kursin e këmbimit për t'u përdorur në njohjen fillestare të aktivit, të shpenzimeve ose të ardhurave që janë të lidhura me paradhënien, kur një njësi ekonomike ka marrë ose ka paguar paradhënie në monedhë të huaj.

¹ Për shembull, paragrafi 106 i SNRF 15 *Të Ardhurat nga Kontratat me Konsumatorët* kërkon që nëse një klient paguan paradhënie, ose një njësi ekonomike ka të drejtë mbi një shumë të pretenduar paradhënie që është e pakushtëzuar (p.sh. një e drejtë e arkëtueshme), përpara se njësi ekonomike të transferojë një mall ose shërbim tek Klienti, njësi ekonomike duhet të paraqesë kontratën si një detyrim kontraktual kur pagesa është bërë ose pagesa është e detyrueshme (cilado që është më e hershme).

Objekti

- 4 Ky Interpretim zbatohet për një transaksion në monedhë të huaj (ose një pjesë e tij) kur një njësi ekonomike njih një aktiv jo-monetar ose detyrim jo-monetar që rrjedh nga pagesa ose marrja e shumës paradhënie përpara se njësia ekonomike të njohë aktivin, shpenzimet ose të ardhurat përkatëse (ose një pjesë të tyre).
- 5 Ky Interpretim nuk zbatohet kur njësia ekonomike mat aktivin, shpenzimet ose të ardhurat përkatëse në njohjen e tyre fillestare:
 - (a) me vlerën e drejtë; ose
 - (b) me vlerën e drejtë të shumës së paguar ose të marrë në një datë të ndryshme nga data e njohjes fillestare e aktivit jo-monetar ose detyrimit jo monetar që rrjedh nga shuma paradhënie (për shembull, matja e emrit të mirë sipas SNRF 3 *Kombinimet e Biznesit*).
- 6 Një njësi ekonomike nuk është e detyruar të zbatojë këtë Interpretim për:
 - (a) tatimin mbi fitimin ose
 - (b) kontratat e sigurimit (përfshirë kontratat e ri sigurimit) që ajo lëshon dhe për kontratat e ri sigurimit që ajo mban.

Çështja

- 7 Ky Interpretim adreson mënyrën e përcaktimit të datës së transaksionit për përcaktimin e kursit të këmbimit që duhet përdorur si në njohjen fillestare të aktivit, shpenzimit ose të ardhurave (ose një pjesë të tyre) që lidhen me paradhënien, ashtu dhe në çregjistrimin e një aktivi jo-monetar ose detyrimi jo-monetar që rrjedh nga pagesa ose marrja e paradhënies në monedhë të huaj.

Konsensusi

- 8 Në zbatim të paragrafëve 21-22 të SNK 21, data e transaksionit për qëllime të përcaktimit të kursit të këmbimit që duhet përdorur në njohjen fillestare të aktivit, shpenzimeve ose të ardhurave (ose një pjesë të tyre), është data në të cilën një njësi ekonomike njih fillimisht aktivin jo-monetar ose detyrimin jo-monetar që rrjedh nga pagesa ose marrja e shumës paradhënie.
- 9 Nëse ka pagesa të shumta të bëra ose të marra në formë paradhënie, njësia ekonomike do të përcaktojë një datë për çdo transaksion pagese të bërë ose të marrë të shumës paradhënie.

Shtojca A

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e KIRNF 22 dhe ka të njëjtin autoritet si pjesët e tjera të KIRNF 22.

Data e hyrjes në fuqi

- A1 Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë Interpretim për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Janar 2018 e në vijim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë Interpretim për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

Periudha kalimtare

- A2 Gjatë zbatimit fillestar, një njësi ekonomike do të zbatojë këtë Interpretim ose:
- (a) duke aplikuar në mënyrë retrospektive SNK 8 *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*, ose
 - (b) në mënyrë prospektive për të gjitha aktivet, shpenzimet dhe të ardhurat që bëjnë pjesë në fushën e këtij Interpretimit si të njohura për herë të parë:
 - (i) në datën e fillimit të periudhës raportuese në të cilën njësia për herë të parë zbaton këtë Interpretim dhe në vijim; ose
 - (ii) në datën e fillimit të një periudhe raportuese paraprake të paraqitur si informacion krahasues në pasqyrat financiare të periudhës raportuese, në të cilën njësia për herë të parë zbaton këtë Interpretim dhe në vijim.
- A3 Një njësi ekonomike që zbaton paragrafin A2 (b) në zbatimin e saj për për herë të parë do të zbatojë këtë Interpretim për aktivet, shpenzimet dhe të ardhurat e njohura për herë të parë në datën e fillimit të periudhës raportuese në paragrafin A2 (b) (i) ose (ii), për të cilat njësia ekonomike ka njohur aktive jo-monetare ose detyrime jo-monetare që rrjedhin nga shumat paradhënie përpara kësaj date, dhe në vijim.

Shtojca B

Ndryshimi në këtë Shtojcë zbatohet për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më 1 janar 2018 e në vijim. Nëse një njësi ekonomike zbaton këtë Interpretim për një periudhë më të hershme, ky ndryshim do të zbatohet për atë periudhë të mëparshme.

Ndryshim në SNRF1 Miratimi për Herë të Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

Është shtuar paragrafi 39AC.

39AC KIRFN 22 *Transaksionet dhe paradhëniet në monedhë të huaj dhe Shumat në Avancë*, shtuan paragrafin D36 dhe ndryshuan paragrafin D1. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim kur ajo të zbatojë KIRFN 22.

Në Shtojcën D, është ndryshuar paragrafi D1. Shtohen një titull dhe paragrafi D36 (teksti i ri është nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes).

- D1 Një njësi ekonomike mund të zgjedhë të përdorë një ose më shumë prej përjashtimeve të mëposhtme:
- (a) transaksionet me pagesë të bazuara në aksione (paragrafët D2 dhe D3);
 - (b) ...
 - (t) përcaktimi i kontratave për të blerë ose shitur një zë jo financiar (paragrafi D33). ~~dhe~~
 - (u) të ardhurat (paragrafi D34 dhe D35); dhe
 - (v) transaksionet dhe paradhëniet në monedhë të huaj (paragrafi D36).

Transaksionet dhe Paradhënia në Monedhë të Huaj

D36 Një adoptues për herë të parë nuk ka nevojë të zbatojë KIRFN 22 *Transaksionet dhe paradhëniet në monedhë të huaj* ndaj aktiveve, shpenzimeve dhe të ardhurave në fushën e këtij Interpretimi të njohura fillimisht përpara datës së kalimit në SNRF.

**Klasifikimi dhe matja
e transaksioneve të pagesave të bazuara në aksione**

(Ndryshime në SNRF 2)

Ndryshime në SNRF 2 Pagesa të bazuara në aksione

Janë ndryshuar paragrafët 19, 30-31, 33, 52 dhe 63, dhe janë shtuar paragrafët 33A-33H, 59A-59B dhe 63D. Janë shtuar titujt përpara paragrafëve 33A dhe 33E. Teksti i fshirë është vijëzuar në mes dhe teksti i ri është nënvizuar. Paragrafët 32 dhe 34 nuk janë ndryshuar, por janë përfshirë për lehtësi referimi.

Trajtimi i kushteve të përfitimit

- 19 Një dhurim instrumenteve të kapitalit neto mund të kushtëzohet me plotësimin e kushteve specifike. Për shembull, një dhurim i i aksioneve ose opsioneve për aksione për një punonjës, zakonisht kushtëzohet nga qëndrimi i punonjësit në njësinë ekonomike për një periudhë kohe të caktuar. Mund të ketë kushte të performancës, që duhet të plotësohen, të tilla si arritja nga ana e njësisë ekonomike e një rritje të caktuar në fitim ose një rritje e specifikuar në çmimin e aksionit të saj. Kushtet specifike, që ndryshojnë nga kushtet e tregut, nuk duhet të merren në konsideratë, kur vlerësohet me çmuarje vlere e drejtë e aksioneve ose opsioneve në aksion në datën e matjes. Në të vërtetë, kushtet specifike, që ndryshojnë nga kushtet e tregut, do të merren parasysh me rregullimin e numrit të instrumenteve të kapitalit neto të përfshirë në matjen e shumës së transaksionit, kështu që si përfundim, shumë e njohur për mallrat ose shërbimet e përfituara, si shumë e instrumenteve të kapitalit neto të dhuruara, do të bazohet në numrin e instrumenteve të kapitalit neto që eventualisht përmbushin kushtet. Pra, duke u nisur nga vlerat akumuluarë, nuk njihet asnjë shumë për mallrat ose shërbimet e përfituara, nëse instrumentet e dhuruara të kapitalit neto nuk mbulohen për shkak të mosplotësimit të një *kondite specifike kushtëzuese, e ndryshme nga një kusht tregtar* p.sh. pala tjetër nuk arrin të plotësojë një periudhë shërbimi të caktuar ose nuk është plotësuar kushti i performancës, siç kërkohet në paragrafin 21.

...

Transaksione të pagesës të bazuara në aksion, që shlyhen në mjete monetare

- 30 Për transaksionet e pagesës të bazuara në aksion që shlyen në mjete monetare, njësia ekonomike do të matë mallrat ose shërbimet e blera dhe detyrimin që ka lindur me vlerën e drejtë të detyrimit, në përputhje me kërkesat e paragrafëve 31-33D. Derisa të shlyhet detyrimi, njësia ekonomike do të rimatë vlerën e drejtë të detyrimit në çdo datë raportimi dhe në datën e shlyerjes dhe çdo ndryshim në vlerë do të njihet në fitimin ose humbjen e periudhës.
- 31 Për shembull, një njësi ekonomike mund t'ju japë punonjësve të saj të drejtat e vlerësimit të aksionit, si pjesë e paketës së shpërblimit të tyre, ndërsa punonjësit do të kenë të drejtën e një pagesë të ardhshme në mjete monetare (dhe jo në një instrument të kapitalit neto), bazuar në rritjen e çmimit të aksionit të njësise ekonomike mbi një nivel të caktuar gjatë një periudhe kohe të caktuar. ~~Ose~~ Për ndryshe, një njësi ekonomike mund t'ju japë punonjësve të vet një të drejtë për marrjen e një pagese të ardhshme në mjete monetare duke ju dhënë atyre të drejtën për aksione (përfshirë aksione për t'u emetuar pas ushtrimit të opsioneve në aksion) të cilat janë të pagueshme, ose në mënyrë të detyrueshme ~~(p.sh. për shembull, pas përfundimit të punësimit) ose në opsionin e punonjësit~~. Këto marrëveshje janë shembuj të transaksioneve të pagesave të bazuara në aksione që shlyen me mjete monetare. Të drejtat e vlerësimit të aksioneve përdoren për të ilustruar disa nga kërkesat në paragrafët 32-33D; megjithatë, kërkesat në këto paragrafë zbatohen për të gjitha transaksionet e pagesave të bazuara në aksione që shlyen me mjete monetare.
- 32 Njësia ekonomike do të njohë shërbimet e përfituara, dhe një detyrim për të paguar këto shërbime, kur punonjësit kryejnë këto shërbime. Për shembull, disa të drejta të vlerësimit të aksionit mbulohen menjëherë dhe prandaj punonjësve nuk u kërkohet të përfundojnë një periudhë të caktuar të shërbimit për të përfituar të drejtën e pagesës në mjete monetare. Në mungesë të evidencës që tregon për të kundërtën, njësia ekonomike do të supozojë se janë përfituar shërbimet e kryera nga punonjësit në këmbim të drejtave të vlerësimit të aksionit. Pra, njësia ekonomike do të njohë menjëherë shërbimet e përfituara dhe një detyrim për të paguar për to. Nëse të drejtat e vlerësimit të aksionit nuk mbulohen derisa punonjësit të kenë përfunduar një periudhë të caktuar të shërbimit, njësia ekonomike do të njohë shërbimet e përfituara dhe detyrimin për të paguar për to, kur punonjësit të kryejnë shërbimin gjatë asaj periudhe.

KLASIFIKIMI DHE MATJA E TRANSAKSIONEVE TË PAGESAVE TË BAZUARA NË AKSIONE

- 33 Detyrimi do të matet, fillimisht dhe në çdo datë raportimi derisa të shlyhet, me vlerën e drejtë të të drejtave të vlerësimit të aksionit, duke zbatuar një model vlerësimi të opsioneve, që merr në konsideratë afatet dhe kushtet sipas të cilave janë dhënë të drejtat e vlerësimit të aksionit dhe madhësinë e shërbimit të kryer nga punonjësit deri në atë datë, sipas kërkesave të paragrafëve 33A-33D. Një njësi ekonomike mund të modifikojë afatet dhe kushtet për të cilat është dhënë një pagesë e bazuar në aksione që shlyen me mjete monetare. Udhëzimi për modifikimin e një transaksioni të pagesës të bazuar në aksione që ndryshon klasifikimin e tij nga të shlyerit me mjete monetare në shlyerje me kapital është dhënë në paragrafët B44A-B44C të Shtojcës B.

Trajtimi i kushteve të përfitimit dhe mos përfitimit

- 33A Një transaksion pagese i bazuar në aksione që shlyet në mjete monetare mund të kushtëzohet me plotësimin e kushteve specifike. Mund të ketë kushte të performancës, që duhet të plotësohen, të tilla si arritja nga ana e njësisë ekonomike e një rritje të caktuar në fitim ose një rritje e specifikuar në çmimin e aksionit të saj. Kushtet specifike, që janë të ndryshme nga kushtet e tregut, nuk duhet të merren në konsideratë kur vlerësohet vlera e drejtë e pagesës të bazuar në aksione që shlyen me mjete monetare në datën e matjes. Në vend të kësaj, kushtet specifike, të ndryshme nga kushtet e tregut, do të merren parasysh me rregullimin e numrit të shpërblimeve të përfshira në matjen e detyrimit që rrjedh nga transaksioni.
- 33B Për të zbatuar kërkesat në paragrafin 33A, njësi ekonomike do të njohë një shumë për mallrat ose shërbimet e marra gjatë periudhës së kushtëzimit. Kjo shumë do të bazohet në vlerësimin më të mirë të mundshëm të numrit të shpërblimeve që pritet të plotësojnë kushtet specifike. Njësi ekonomike do të rishikojë këtë vlerësim, nëse është e nevojshme, kur informacioni i mëpasshëm tregon se numri i shpërblimeve të pritshme që plotësojnë kushtet e përfitimit, ndryshon nga vlerësimet e mëparshme. Në datën e plotësimit të kushteve, njësi ekonomike do të rishikojë vlerësimin për të barazuar numrin e shpërblimeve që plotësojnë kushtet përfundimisht.
- 33C Kushtet e tregut, si p.sh. një nivel i caktuar i çmimit të aksionit për të cilin është vendosur kushtëzimi, (ose e drejta e ushtrimit), si dhe kushtet jo-kushtëzuese, duhet të merren parasysh gjatë vlerësimit të vlerës së drejtë të pagesës së bazuar në aksione që shlyet me mjete monetare të dhëna dhe kur rimatim vlerën e drejtë në fund të çdo periudhe raportuese dhe në datën e shlyerjes.
- 33D Si rezultat i zbatimit të paragrafëve 30-33C, shuma e akumuluar e njohur përfundimisht për mallrat ose shërbimet e marra si pagesë për transaksionin e bazuar në aksione që shlyet me mjete monetare, është e barabartë me shumën e mjeteve monetare që paguhet.

Transaksionet e pagesave të bazuara në aksione me një tipar të shlyerjes neto nga detyrimet për tatimin në burim

- 33E Ligjet ose rregullat tatimore mund të detyrojnë një njësi ekonomike të mbajë një shumë si detyrim për tatimin në burim ndaj një punonjësi që ka lidhje me një pagesë të bazuar në aksione dhe transferimin e kësaj shume, normalisht në mjete monetare, tek organet tatimore në emër të punonjësit. Për të përmbushur këtë detyrim, kushtet e marrëveshjes së pagesës së bazuar në aksione mund të lejojnë ose të kërkojnë që njësi ekonomike të mbajë një numër të instrumenteve të kapitalit neto të barabartë me vlerën monetare të detyrimit tatimor të punonjësit nga numri i përgjithshëm i instrumenteve të kapitalit neto që do të ishin lëshuar për këtë punonjës në momentin e ushtrimit (ose të plotësimit të kushteve) të pagesës së bazuar në aksione (pra marrëveshja e pagesës së bazuar në aksione ka një 'veçori të shlyerjes për shumën neto').
- 33F Si përjashtim ndaj kërkesave në paragrafin 34, transaksioni i përshkruar në paragrafin 33E do të klasifikohet në tërësinë e tij si një transaksion pagese i bazuar në aksione që shlyet me instrumente të kapitalit neto nëse do të ishte klasifikuar si i tillë në mungesë të tiparit për shlyerje neto.
- 33G Njësi ekonomike zbaton paragrafin 29 të këtij Standardi për të llogaritur mbajtjen e aksioneve për të financuar pagesën e tatimit në burim tek organet tatimore që kanë lidhje me detyrimin e tatimit në burim të punonjësit, që rrjedh nga kjo pagesë e bazuar në aksione. Prandaj, pagesa e bërë do të llogaritet si një zbritje nga kapitali për aksionet e mbajtura, përveçse në rastin kur pagesa tejkalon vlerën e drejtë në datën e shlyerjes për neto të instrumenteve të kapitalit neto të mbajtura si tatim në burim.
- 33H Përjashtimi në paragrafin 33F nuk zbatohet për:
- (a) një marrëveshje pagese të bazuar në aksione me një tipar të shlyerjes neto për të cilën nuk ka detyrim për njësinë ekonomike sipas ligjeve ose rregullave tatimore, për të mbajtur tatim në burim për një punonjës që ka lidhje me atë pagesë të bazuar në aksione; ose
 - (b) çdo instrument kapitali që njësi ekonomike i ka mbajtur më tepër sesa detyrimi tatimor përkatës i punonjësit, që ka lidhje me pagesën e bazuar në aksione (pra njësi ekonomike ka mbajtur një

sasi aksionesh që tejkalon vlerën monetare të detyrimit tatimor të punonjësit). Këto aksione të tepërta të mbajtura në burim duhet të trajtohen si një pagesë e bazuar në aksione që shlyen me mjete monetare, kur kjo shumë paguhet në mjete monetare (ose pasuri të tjera) tek punonjësi.

- 34 **Për transaksionet e pagesës të bazuara në aksion në të cilat kushtet e marrëveshjes i sigurojnë ose njësisë ekonomike ose palës tjetër një zgjedhje nëse njësia ekonomike do të shlyejë transaksionin në mjete monetare (ose aktive të tjera) ose duke emetuar instrumente të kapitalit neto, njësia ekonomike do ta trajtojë atë transaksion, ose përbërës të atij transaksioni, si transaksion të pagesës të bazuar në aksione për t'u shlyer në mjete monetare, nëse dhe në deri në masën në të cilën njësia ekonomike ka pësuar një detyrim për t'u shlyer në mjete monetare ose në aktive të tjera, ose si një transaksion të pagesës së bazuar në aksione për t'u shlyer me kapital neto nëse dhe deri në masën që nuk është pësuar një detyrim i tillë.**

Dhënia e informacioneve shpjeguese

- 52 Nëse informacioni i kërkuar për t'u shpjeguar nga ky SNRF Standard, nuk plotëson parimet në paragrafët 44, 46 dhe 50, njësia ekonomike do të japë këtë informacion shpjegues si informacion shtesë të nevojshëm për të plotësuar këto kërkesa. Për shembull, nëse një njësi ekonomike ka klasifikuar ndonjë transaksion pagese të bazuar në aksione si transaksione të shlyera me instrumente të kapitalit në përputhje me paragrafin 33F, ajo do të japë shpjegim të vlerësimit të shumës që pret të transferojë tek organet tatimore për të paguar detyrimin tatimor të punonjësit, në ato raste kur është e nevojshme të informohen përdoruesit për efektet e mundshme të fluksit të mjeteve monetare që lidhen me marrëveshjen e pagesës së bazuar në aksione.

Dispozitat kalimtare

- 59A Një njësi ekonomike do të zbatojë ndryshimet në paragrafët 30-31, 33-33H dhe B44A-B44C siç përcaktohet më poshtë. Periudhat e mëparshme nuk do të riparaqiten.
- (a) Ndryshimet në paragrafët B44A-B44C zbatohen vetëm për ndryshimet që ndodhin në datën që njësia ekonomike i zbaton ndryshimet për herë të parë e në vijim.
 - (b) Ndryshimet në paragrafët 30-31 dhe 33-33D zbatohen për transaksionet e pagesave të bazuara në aksione që nuk kanë plotësuar kushtet specifike në datën kur një njësi ekonomike zbaton ndryshimet për herë të parë dhe për transaksionet e pagesave të bazuara në aksione të dhëna në datën kur një njësi ekonomike zbaton ndryshimet për herë të parë e në vijim. Për transaksionet e pagesave të bazuara në aksione të dhëna përpara datës kur njësia ekonomike zbaton ndryshimet për herë të parë, por që nuk kanë plotësuar kushtet specifike, një njësi ekonomike do të rimasë detyrimin në atë datë dhe të njohë efektin e rimatjes në tepricën e fitimeve të pa shpërndara të periudhës raportuese, në të cilën ndryshimet zbatohen për herë të parë (ose sipas rastit, në një përbërës tjetër të kapitalit neto).
 - (c) Ndryshimet në paragrafët 33E-33H dhe ndryshimi në paragrafin 52 zbatohen për transaksionet e pagesave të bazuara në aksione që nuk kanë plotësuar kushtet specifike (ose kanë plotësuar kushtet, por nuk është ushtruar e drejta e tyre) në datën kur një njësi ekonomike zbaton ndryshimet për herë të parë dhe për transaksionet e pagesave të bazuara në aksione të dhëna në datën kur një njësi ekonomike zbaton ndryshimet për herë të parë e në vijim. Për transaksionet e pagesave të bazuara në aksione (ose përbërësit e tyre) që nuk kanë plotësuar kushtet specifike (ose i kanë plotësuar por nuk është ushtruar e drejta) të cilat janë klasifikuar më parë si pagesa të bazuara në aksione që shlyen me mjete monetare, por që tani janë klasifikuar si transaksione që shlyen me instrumente kapitali, në përputhje me ndryshimet, një njësi ekonomike do të riklasifikojë vlerën e detyrimit të pagesës së bazuar në aksione, në kapitalin neto në datën kur ajo zbaton ndryshimet për herë të parë.
- 59B Pavarësisht nga kërkesat në paragrafin 59A, një njësi ekonomike mund të zbatojë ndryshimet në paragrafin 63D në mënyrë retrospektive, në përputhje me dispozitat kalimtare në paragrafët 53-59 të këtij Standardi, në përputhje me SNK 8 *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*, nëse dhe vetëm nëse, është e mundur pa ndodhur akoma. Nëse një njësi ekonomike zgjedh zbatimin retrospektiv, ajo duhet ta bëjë këtë për të gjitha ndryshimet e bëra nga *Klasifikimi dhe Matja e Transaksioneve të Pagesave të Bazuara në Aksione* (Ndryshimet në SNRF 2).

Data e hyrjes në fuqi

- ...
- 63 Një njësi ekonomike do të zbatojë ndryshimet e mëposhtme të bëra në *Transaksionet për pagesa të bazuara në aksione të shlyera në mjete monetare të grupit*, të emetuar në qershor 2009 në mënyrë retrospektive, sipas dispozitave kalimtare në paragrafët 53-59, në përputhje me SNK 8 *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet* për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2010:
- (a) ...
- ...
- 63D Klasifikimi dhe Matja e Transaksioneve të Pagesave të Bazuara në Aksione (Ndryshimet në SNRF 2), të publikuara në qershor 2016, ka ndryshuar paragrafët 19, 30-31, 33, 52 dhe 63 dhe ka shtuar paragrafët 33A-33H, 59A-59B, 63D dhe B44A-B44C dhe titujt që lidhen me to. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore nga data 1 janar 2018 e në vazhdim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimet për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

Në Shtojcën B janë fshirë paragrafët B44A - B44C dhe titujt përkatës. Teksti i ri është i nënvizuar.

Kontabiliteti për një modifikim të një transaksioni të pagesave të bazuar në aksione që ndryshon klasifikimin e tij nga shlyerja me mjete monetare në shlyerje me instrumentet të kapitalin neto

- B44A Nëse kushtet dhe afatet e një transaksioni të pagesës së bazuar në aksione që shlyen me mjete monetare, ndryshohen dhe ai bëhet transaksion i pagesës së bazuar në aksione që shlyet me instrumentet të kapitalit neto, transaksioni kontabilizohet si i tillë që nga data e modifikimit. Në mënyrë specifike:
- (a) Transaksioni i pagesës së bazuar në aksione që shlyet me instrumente të kapitalit neto matet me referencë të vlerës së drejtë të instrumenteve të kapitalit neto të dhëna në datën e modifikimit. Transaksioni i pagesës së bazuar në aksione të shlyera me instrumente të kapitalit neto njihet në kapitalin neto në datën e modifikimit deri në masën në të cilën janë pranuar mallrat ose shërbimet.
 - (b) Detyrimi për transaksionin e pagesave të bazuara në aksione të shlyera me mjete monetare, në datën e modifikimit, çregjistrohet në atë datë.
 - (c) Cdo diferencë midis vlerës kontabël të detyrimit të çregjistruar dhe shumës së kapitalit neto të njohur në datën e modifikimit njihet menjëherë në fitim ose humbje.
- B44B Nëse, si rezultat i modifikimit, periudha e kushtëzimit zgjatet ose shkurtohet, zbatimi i kërkesave në paragrafin B44A reflekton periudhën e modifikuar të kushtëzimit. Kërkesat e paragrafit B44A zbatohen edhe nëse modifikimi ndodh pas periudhës së kushtëzimit.
- B44C Një transaksion i pagesave të bazuara në aksione mund të anulohet ose të shlyhet (i ndryshëm nga transaksioni i anuluar me konfiskim kur kushtet e kushtëzimit nuk plotësohen). Nëse instrumentet e kapitalit neto janë dhënë, dhe në datën e dhënies, njësia ekonomike i identifikon ato si një zëvendësim për pagesën e anuluar të bazuar në aksione, që shlyen me mjete monetare, njësia ekonomike duhet të zbatojë paragrafët B44A dhe B44B.

Sqarime për SNRF 15
Të Ardhurat nga Kontratat me Klientët

SQARIME PËR SNRF 15 TË ARDHURAT NGA KONTRATAT ME KLIENTËT - PRILL 2016

Ndryshime në SNRF 15 Të ardhurat nga Kontratat me Klientët

Janë ndryshuar paragrafët 26, 27 dhe 29. Teksti i fshirë është shënuar me vijë në mes dhe teksti i ri është nënvizuar. Paragrafët 28 dhe 30 nuk janë ndryshuar, por janë përfshirë për lehtësi referimi.

Dallimi i mallrave ose shërbimeve

26 Në varësi të kontratës, mallrat apo shërbimet e premtuara mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në, sa vijon:

- (a) shitje mallrash të prodhuara nga një njësi ekonomike (për shembull, inventarët e një prodhuesi);
- (b) rishitja e mallrave të blera nga një njësi ekonomike (për shembull, malli i një shitësi me pakicë);
- (c) rishitja e të drejtave për mallra apo shërbime të blera nga një njësi ekonomike (për shembull një biletë e shitur nga një njësi ekonomike që vepron për llogari të vet, siç përshkruhet në paragrafët B34–B38);
- (d) kryerja, për një klient, e një ose më shumë detyrave të rëna dakord në kontratë;
- (e) gatishmëria për të ofruar mallra ose shërbime (për shembull, përditësime të papërcaktuara të programeve kompjuterike të cilat ofrohen kur dhe nëse ka nevojë për to) ose vënia në dispozicion të klientit, të mallrave apo shërbimeve për t'i përdorur si dhe kur ai dëshiron;
- (f) ofrimi i një shërbimi ndërmjetësimi për të transferuar mallra apo shërbime tek një klient (për shembull, duke vepruar si agjent për një palë tjetër, siç përshkruhet në paragrafët B34–B38);
- (g) dhënia e të drejtave për mallra apo shërbime që do të ofrohen në të ardhmen dhe që një klient mund t'i rishesë ose të furnizojë klientët e vet (për shembull, njësi ekonomike duke shitur një produkt tek një shitës me pakicë premtton të transferojë një mall apo shërbim shtesë tek një individ që blen produktin nga shitësi me pakicë);
- (h) ndërtimi, prodhimi ose zhvillimi i një aktivi për llogari të një klienti;
- (i) dhënia e licencave (shih paragrafët B52–B63B); dhe
- (j) dhënia e opsioneve për blerje mallrash apo shërbimesh shtesë (nëse këto opsione i japin klientit një të drejtë të rëndësishme, siç përshkruhet në paragrafët B39–B43).

27 Një mall apo shërbim i premtuar tek një klient, është i dallueshëm nëse plotësohen njëkohësisht të dy kriteret në vijim:

- (a) klienti mund të përfitojë nga malli apo shërbimi i marrë vetëm ose së bashku me burime të tjera, që janë tashmë në dispozicion të klientit (d.m.th malli apo shërbimi ekziston në mënyrë të dallueshme); dhe
- (b) premtimi i njësisë ekonomike për të transferuar mallra apo shërbime tek klienti identifikohet veçmas nga premtimet e tjera në kontratë (d.m.th premtimi për të transferuar mallin apo shërbimin është i dallueshëm në kontekstin e kontratës).

28 Një klient mund të përfitojë nga një mall apo shërbim në përputhje me paragrafin 27(a) nëse malli apo shërbimi mund të përdoret, konsumohet, shitet për një shumë më të madhe se vlera si mbeturinë ose mund të mbahet në mënyrë të tjera të cilat sjellin përfitime ekonomike. Për disa mallra apo shërbime, klienti mund të jetë në gjendje të nxjerrë përfitime nga përdorimi veçmas i tyre. Për mallra apo shërbime të tjera klienti mund të jetë në gjendje të nxjerrë përfitime vetëm nga përdorimi i tyre së bashku me burime të tjera të gatshme. Një burim tjetër i gatshëm është një mall apo shërbim që shitet veçmas (nga njësi ekonomike ose një njësi tjetër) ose një burim që klienti e ka marrë tashmë nga njësi ekonomike (përfshirë mallrat apo shërbimet që njësi ekonomike duhet të ketë transferuar tashmë tek klienti sipas kontratës) ose nga transaksione dhe ngjarje të tjera. Faktorë të ndryshëm mund të tregojnë se klienti mund të përfitojë nga një mall apo shërbim veçmas ose së bashku me burime të tjera të gatshme. Fakti që njësi ekonomike shet në

mënyrë të rregullt një mall apo shërbim veçmas është një shembull që mund të tregojnë se klienti mund të përfitojë nga një mall apo shërbim veçmas ose së bashku me burime të tjera të gatshme.

- 29 Në vlerësimin nëse premtimet e një njësie ekonomike për të transferuar mallra ose shërbime ndaj klientit janë të identifikueshme veçmas në përputhje me paragrafin 27 (b), objektivi është të përcaktojë nëse natyra e premtimit, brenda kontekstit të kontratës, është të transferojë secilën nga mallrat ose shërbimet individualisht ose, në vend të kësaj, të transferojnë një send të kombinuar ose sende, për të cilat mallrat ose shërbimet e premtuara janë elementë përbërës (inpute). Faktorët që tregojnë se premtimi i një njësie ekonomike dy ose më shumë premtime për të transferuar një mall ose shërbim mallra ose shërbime tek një klient nuk është janë të identifikueshme veçmas (në përputhje me paragrafin 27 (b)) përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në sa më poshtë:

- (a) njësia ekonomike nuk kryen jep një shërbim të rëndësishëm në integrimin -mallit ose shërbimit e mallrave ose shërbimeve me mallra ose shërbime të tjera të premtuara në kontratë në një grumbull mallrash ose shërbimesh që përfaqësojnë prodhimin ose prodhimet e kombinuara për të cilat klienti e ka kontraktuar. Me fjalë të tjera, njësia ekonomike nuk po përdor mallin ose shërbimin si një input mallrat ose shërbimet si elementë përbërës (inpute) për të prodhuar ose shpërndarë prodhimin ose prodhimet e kombinuara të specifikuar nga klienti. Një prodhim ose prodhime të kombinuara mund të përfshijnë më shumë se një fazë, një element ose një njësi.
- (b) një ose më shumë nga malli ose shërbimi nuk mallrat ose shërbimet në mënyrë të konsiderueshme modifikon ose personalizon modifikon ose personalizojn, apo janë të modifikuara ose te personalizuar në mënyrë të konsiderueshme nga një ose më shumë një mall ose shërbim tjetër mallra ose shërbime të tjera të premtuara në kontratë.
- (c) malli apo shërbimi nuk është i varur dukshëm nga ose me mallra ose shërbime të tjera të premtuara në kontratë mallrat ose shërbimet janë shume te ndërruara ose të ndërlidhura. Për shembull fakti që një klient mund të vendosë të mos blejë mallin apo shërbimin pa ndikuar në mënyrë të rëndësishme në mallrat apo shërbimet e tjera në kontratë mund të jetë tregues se malli apo shërbimi nuk varet shumë ose nuk është i lidhur fort me mallrat apo shërbimet e tjera të premtuara. Me fjalë të tjera, secili prej mallrave ose shërbimeve ndikohet dukshëm nga një ose më shumë mallra ose shërbime të tjera në kontratë. Për shembull, në disa raste dy ose më shumë mallra ose shërbime janë prekur ndjeshëm nga njëra-tjetra, sepse njësia ekonomike nuk do të ishte në gjendje të përmbushte premtimin e saj duke transferuar secilën prej mallrave ose shërbimeve në mënyrë të pavarur.

- 30 Nëse malli apo shërbimi nuk është i dallueshëm, njësia ekonomike duhet të kombinojë atë mall apo shërbim me mallra apo shërbime të tjera të premtuara derisa të identifikojë grupin e mallrave apo shërbimeve që janë të dallueshëm. Në disa raste kjo mund të sjellë që njësia ekonomike t'i trajtojë të gjitha mallrat apo shërbimet e premtuara në një kontratë si një kusht i vetëm performance.

Në Shtojcën B, paragrafët B1, B34-B38, B52-B53 dhe B58 janë ndryshuar dhe janë shtuar paragrafët B34A, B35A, B35B, B37A, B59A, B63A dhe B63B. Paragrafi B57 është fshirë. Teksti i fshirë është vijëzuar në mes dhe teksti i ri është nënvizuar. Paragrafët B54-B56 dhe B60-B63 nuk janë ndryshuar, por janë përfshirë për lehtësi referimi.

Shtojca B

Udhëzim për zbatim

...

- B1 Ky udhëzim për zbatim është organizuar sipas kategorive në vijim:

- (a) ...
- (i) dhënia e licencës (paragrafët B52–B63B);
- (j) ...

SQARIME PËR SNRF 15 TË ARDHURAT NGA KONTRATAT ME KLIENTËT - PRILL
2016

Shumat kryesore kundrejt shumave të agentit

- B34 Kur një palë tjetër përfshihet në ofrimin e mallrave apo shërbimeve tek një klient, njësia ekonomike duhet të përcaktojë nëse natyra e premtimit të saj është një kusht performance për të ofruar vetë mallrat apo shërbimet e specifikuar (d.m.th njësia ekonomike është njësi kryesore) ose për të ndihmuar që këto mallra ose shërbime të ofrohen nga pala tjetër të ofrojë ato mallra apo shërbime (d.m.th njësia ekonomike është njësi agent). Një njësi ekonomike përcakton nëse ajo është një njësi kryesore apo një agent për çdo mall të specifikuar ose shërbim të premtuar ndaj klientit. Një mall ose shërbim i specifikuar është një mall ose shërbim i dallueshëm (ose një pako e veçantë e mallrave ose shërbimeve) që duhet t'i ofrohen klientit (shih paragrafët 27-30). Nëse një kontratë me një klient përfshin më shumë se një mall ose shërbim të specifikuar, një njësi ekonomike mund të jetë njësi kryesore për disa mallra ose shërbime të specifikuar dhe një agent për disa të tjerë.
- B34A Për të përcaktuar natyrën e premtimit të saj (siç përshkruhet në paragrafin B34), njësia ekonomike duhet:
- (a) të identifikojë mallrat ose shërbimet e specifikuar që duhet t'i ofrohen klientit (të cilat, për shembull, mund të jenë e drejta për një mall ose shërbim që duhet të sigurohet nga një palë tjetër (shih paragrafin 26)); dhe
 - (b) të vlerësojë nëse ajo ka kontrollin (siç përshkruhet në paragrafin 33) mbi çdo mall ose shërbim të specifikuar para se malli ose shërbimi t'i transferohet klientit.
- B35 Një njësi ekonomike është njësi kryesore në qoftë se ~~njësia ekonomike~~ ajo kontrollon një mall ose shërbim të specifikuar përpara se ~~njësia ekonomike të transferojë~~ ai mall ose shërbim të transferohet tek një klient. Megjithatë, një njësi ekonomike jo është detyrimsht ~~duke vepruar si njësi kryesore~~ kontrollon një mall specifik nëse njësia ekonomike ka titullin ligjor të ~~një produkti~~ atij malli vetëm pak kohë përpara se titulli ligjor të transferohet tek klienti. Një njësi ekonomike që është një njësi kryesore ~~në një kontratë~~ mund të përmbushë detyrimin e saj ~~duke~~ për të ofruar mallin ose shërbimin e specifikuar vetë ose mund të angazhojë një palë tjetër (për shembull një nënkontraktor) për të përmbushur disa ose të gjithë detyrimet e performancës në emër të tij. Kur njësia ekonomike, që është njësi kryesore, plotëson një kusht performance, njësia ekonomike njih të ardhurat për shumën bruto korresponduese për të cilën pret që të ketë të drejtë në këmbim të atyre mallrave apo shërbimeve të transferuara.
- B35A Kur një palë tjetër është e përfshirë në ofrimin e mallrave ose shërbimeve për një klient, një njësi ekonomike që është njësi kryesore merr kontrollin e:
- (a) një malli ose një aktivi tjetër nga pala tjetër që pastaj ia transferon klientit.
 - (b) një të drejtë për një shërbim që duhet të kryhet nga pala tjetër, e cila i jep njësisë ekonomike aftësinë për të drejtuar atë palë tjetër për të ofruar shërbimin ndaj klientit në emër të njësisë ekonomike.
 - (c) një malli ose shërbimi të palës tjetër që pastaj kombinohet me mallra ose shërbime të tjera kur ofrohet një mall ose shërbim i specifikuar tek klienti. Për shembull, nëse një njësi ekonomike ofron një shërbim të rëndësishëm që përfshin mallra të integruara ose shërbime (shih paragrafin 29 (a)) të ofruara nga një palë tjetër, në formën e një malli ose shërbimi specifik, të kontraktuara nga klienti, njësia ekonomike kontrollon mallin ose shërbimin specifik përpara se malli ose shërbimi i transferohet klientit. Kjo ndodh për shkak se njësia ekonomike fillimisht merr kontrollin e elementëve përbërës (inputeve) të mallrave ose shërbimeve të specifikuar (që përfshin mallra ose shërbime nga palët e tjera) dhe kthen përdorimin e tyre për të krijuar produktin e kombinuar që është malli ose shërbimi i specifikuar.
- B35B Kur (ose sapo) njësia ekonomike, që është njësi kryesore, plotëson një kusht të performancës, njësia ekonomike njih të ardhurat për shumën bruto, për të cilën pret që në këmbim të tyre të ketë të drejtë mbi këto mallra apo shërbime të transferuara.
- B36 Një njësi ekonomike është një agent nëse kushti i performancës i njësisë ekonomike është që të ndihmojë për ofrimin e ~~mallrave apo shërbimeve~~ mallit ose të shërbimit të specifikuar nga një palë tjetër. Një njësi ekonomike që është një agent nuk kontrollon mallin ose shërbimin e specifikuar, të dhënë nga një palë tjetër para se malli ose shërbimi të transferohet tek klienti. Kur (ose sapo) një njësi ekonomike që është agent plotëson një kusht performance, njësia ekonomike njih të ardhurat në madhësinë e ndonjë tarife ose komisioni për të cilën pret të ketë të drejtë në këmbim të ndihmës ~~ndaj palës tjetër për të ofruar~~ për mallrat apo shërbimet e specifikuar për tu dhënë nga pala tjetër. Tarifa ose komisioni i një njësie ekonomike mund të jetë shuma neto e shumës korresponduese që njësia ekonomike mban pasi i paguan palës tjetër shumën korresponduese të marrë në këmbim të mallrave apo shërbimeve që do të ofrohen nga ajo palë.
- B37 Treguesit që një njësi ekonomike ~~është një agent (dhe për këtë arsye nuk kontrollon)~~ kontrollon mallrat ose shërbimet e specifikuar para se të ~~ofrohen~~ transferohen tek një klient) (dhe për këtë arsye është një njësi kryesore (shih paragrafin B35)) përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në sa vijon:

- (a) një palë tjetër, njësi ekonomike është kryesisht përgjegjëse për përmbushjen e kontratës; premtimit për të dhënë mallin ose shërbimin e specifikuar. Kjo zakonisht përfshin përgjegjësinë për pranueshmërinë e mallit ose shërbimit të specifikuar (për shembull, përgjegjësia primare për mallin ose shërbimin që të plotësojë specifikimet e konsumatorit). Nëse njësi ekonomike është kryesisht përgjegjëse për përmbushjen e premtimit për të ofruar mallin ose shërbimin e specifikuar, kjo mund të tregojë se pala tjetër e përfshirë në dhënie e mallit ose shërbimit të specifikuar, po vepron në emër të njësisë ekonomike.
- (b) njësi ekonomike nuk ka rrezik për inventarin para ose pasi mallrat janë porositur se malli ose shërbimi i specifikuar të jete transferuar tek një klient gjatë transportit të tyre ose në kthim; ose pas transferimit të kontrollit tek klienti (për shembull, nëse klienti ka të drejtën e kthimit). Për shembull, nëse njësi ekonomike merr ose angazhohet vetë për të marrë, mallin ose shërbimin e specifikuar përpara se të nënshkruaje një kontratë me një klient, kjo mund të tregojë se njësi ekonomike ka aftësinë të drejtë përdorimin dhe të marrë në mënyre thelbësore të gjitha përfitimet e mbetura nga malli ose shërbimi para se ai të transferohet tek klienti.
- (c) njësi ekonomike nuk ka liniveprimin të përcaktojë çmime çmimin për mallrat apo shërbimet e palës tjetër dhe prandaj përfitimi që njësi ekonomike mund të marrë nga këto mallra apo shërbime është i kufizuar mallin ose shërbimin e specifikuar. Përcaktimi i çmimit që konsumatori paguan për mallin ose shërbimin e specifikuar, mund të tregojë se njësi ekonomike ka aftësinë të drejtë përdorimin e atij malli ose shërbimi dhe të marrë në mënyre thelbësore të gjitha përfitimet që mbeten. Megjithatë, në disa raste, një agjent mund të ketë liri veprimi në vendosjen e çmimeve. Për shembull, një agjent mund të ketë njëfarë fleksibiliteti në caktimin e çmimeve në mënyrë që të gjenerojë të ardhura shtesë nga shërbimi i tij për ndërmjetësimin e mallrave ose shërbimeve që duhet të ofrohen nga palët e tjera për klientët.
- (d) shuma korresponduese e njësisë ekonomike është në formën e një komisioni; dhe
- (e) njësi ekonomike nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë për shumën e arkëtueshme nga një klient në këmbim të mallrave apo shërbimeve të palës tjetër.

B37A Treguesit në paragrafin B37 mund të jenë pak a shumë të rëndësishëm për vlerësimin e kontrollit në varësi të natyrës së mallrave ose shërbimeve të specifikuar dhe termave dhe kushteve të kontratës. Përveç kësaj, tregues të ndryshëm mund të ofrojnë dëshmi më bindëse në kontrata të ndryshme.

B38 Nëse një njësi ekonomike tjetër merr përsipër kushtet e performancës së njësisë ekonomike dhe të drejtat kontraktuale në kontratë në mënyrë të tillë që njësi ekonomike nuk është më e detyruar të plotësojë kushtin e performancës për të transferuar mallin apo shërbimin e premtuar specifikuar tek klienti (d.m.th njësi ekonomike nuk vepron më si njësi kryesore), njësi ekonomike nuk duhet të njohë të ardhurat nga ai kusht performance. Por njësi ekonomike duhet të vlerësojë nëse duhet të njohë të ardhurat nga plotësimi i një kushti performance për marrjen e një kontrate nga pala tjetër (d.m.th nëse njësi ekonomike po vepron si agjent).

...

Licensimi

B52 Një licensë përcakton të drejtat e klientit mbi pronësinë intelektuale të një njësie ekonomike. Licencat për pronësinë intelektuale mund të përfshijnë por nuk kufizohen në licensat e mëposhtme:

- (a) programe kompjuterikë dhe teknologji;
- (b) filma, muzikë dhe forma të tjera të komunikimit dhe argëtimit;
- (c) franshizat; dhe
- (d) patentat, të drejtat për emrin tregtar dhe të drejtat e autorit.

B53 Përveç premtimit për të garantuar një licensë (ose licensa) për një klient, njësi ekonomike mund të premtojë edhe transferimin e mallrave apo shërbimeve të tjera tek klienti. Këto premtime mund të shprehen qartë në kontratë ose të nënkuptohen nga praktikat e zakonshme të biznesit të njësisë ekonomike, nga politikat e publikuara ose deklaratat specifike (shih paragrafin 24). Ashtu si dhe me kontratat e tjera, nëse një kontratë me një klient përfshin një premtim për të garantuar një licensë (ose licensa) përveç mallrave apo shërbimeve të tjera të premtuara, njësi ekonomike zbaton paragrafët 22–30 për të identifikuar secilin prej kushteve të performancës në kontratë.

B54 Nëse premtimi për të garantuar një licensë nuk është i dallueshëm nga mallrat apo shërbimet e tjera të premtuara në kontratë në përputhje me paragrafët 26–30, një njësi ekonomike do ta trajtojë premtimin për dhënie license dhe mallrat apo shërbimet e tjera të premtuara së bashku me të, si një kusht të vetëm

SQARIME PËR SNRF 15 TË ARDHURAT NGA KONTRATAT ME KLIENTËT - PRILL 2016

performance. Shembuj të licensave, të cilat nuk janë të dallueshme nga mallrat apo shërbimet e premtuara në kontratë, përfshijnë sa vijon:

- (a) një licensë që është pjesë përbërëse e një malli të prekshëm dhe që është i integruar në funksionimin e mallit; dhe
 - (b) një licensë që klienti mund të përfitojë vetëm së bashku me një shërbim të lidhur (si për shembull, një shërbim online i ofruar nga njësi ekonomike, e cila nëpërmjet dhënies së licensës i mundëson klientit të përdorë përmbajtjen).
- B55 Nëse licensa nuk është e dallueshme, një njes ekonomike do të zbatojë paragrafët 31–38 për të përcaktuar nëse kushti i performancës (që përfshin licensën e premtuar) është një kusht performance, i cili plotësohet gjatë kohës së kontratës ose në një moment kohor të caktuar.
- B56 Nëse premtimi për të dhënë licensën është i dallueshëm nga mallrat apo shërbimet e tjera të premtuara në kontratë dhe për këtë arsye premtimi për dhënie license është një kusht i veçantë performance, një njësi ekonomike do të përcaktojë nëse licensa transferon tek klienti në një moment kohor të caktuar apo gjatë gjithë kohës së kontratës. Për të bërë këtë përcaktim njësi ekonomike duhet të marrë në konsideratë nëse natyra e premtimit të njësisë ekonomike për dhënie license për një klient është që t'i ofrojë klientit ose:
- (a) një të drejtë për të përdorur pronësinë intelektuale të njësisë ekonomike siç ekziston, gjatë periudhës së licensës; ose
 - (b) një të drejtë për të përdorur pronësinë intelektuale të njësisë ekonomike siç ekziston, në një moment kohor të caktuar për të cilin jepet licensa.

Përcaktimi i natyrës së premtimit të njësisë ekonomike

- B57 ~~Për të përcaktuar nëse premtimi i njësisë ekonomike për të dhënë një licensë i ofron klientit një të drejtë për të konsultuar pronësinë intelektuale të njësisë ekonomike apo një të drejtë për të përdorur pronësinë intelektuale të njësisë ekonomike, një njësi ekonomike duhet të marrë në konsideratë nëse klienti mund të menaxhojë përdorimin dhe të marrë pothuajse të gjitha përfitimet e mbetura nga një licensë në një moment kohor në të cilin është dhënë licensa. Klienti nuk mund të menaxhojë përdorimin dhe të marrë pothuajse të gjitha përfitimet e mbetura nga një licensë në një moment kohor të caktuar në të cilin është dhënë licensa, nëse pronësia intelektuale për të cilën klienti ka të drejtë ndryshon gjatë periudhës së licensës. Pronësia intelektuale do të ndryshojë (dhe prandaj do të ndikojë vlerësimin e njësisë ekonomike nëse klienti kontrollon licensën) nëse njësi ekonomike vazhdon të jetë e përfshirë me pronësinë e saj intelektuale dhe njësi ekonomike ndërmerr aktivitete të cilat ndikojnë shumë pronësinë intelektuale për të cilën klienti ka të drejtë. Në këto raste, licensa i ofron klientit një të drejtë për konsultim në pasurinë intelektuale të njësisë ekonomike (shih paragrafin B58). Nga ana tjetër, klienti mund të menaxhojë përdorimin dhe të marrë pothuajse të gjitha përfitimet e mbetura nga një licensë në një moment kohor të caktuar në të cilin është dhënë licensa, nëse pronësia intelektuale për të cilën klienti ka të drejtë nuk ndryshon (shih paragrafin 61). Në këto raste, çdo aktivitet i ndërmarrë nga njësi ekonomike nuk e ndryshon thuajse fare aktivin e vet (d.m.th. pronësinë intelektuale në fjalë), që mund të ndikojë në aftësinë e njësisë ekonomike për të ofruar licensa në të ardhmen; megjithatë këto aktivitete nuk do të ndikojnë përcaktimin se çfarë ofron licensa ose çfarë kontrollon klienti. [Fshirë]~~
- B58 Natyra e premtimit të një njësie ekonomike për dhënie license është një premtim për të ofruar një të drejtë hyrjeje në pronësinë intelektuale të njësisë ekonomike nëse plotësohen të gjitha kriteret në vijim:
- (a) kontrata kërkon ose klienti pret në mënyrë të arsyeshme që njësi ekonomike do të ndërmarrë aktivitete, të cilat ndikojnë shumë në pronësinë intelektuale për të cilën klienti ka të drejtë (shih paragrafët B59 dhe B59A);
 - (b) të drejtat e dhëna nga licensa ekspozojnë klientin drejtpërdrejt ndaj efekteve pozitive ose negative të aktiviteteve të njësisë ekonomike të identifikuar në paragrafin B58(a); dhe
 - (c) këto aktivitete, me ndodhjen e tyre, nuk sjellin transferimin e një malli apo shërbimi tek klienti (shih paragrafin 25).
- B59 Faktorët që mund të tregojnë se një klient pret në mënyrë të arsyeshme që një njësi ekonomike do të ndërmarrë aktivitete të cilat do të ndikojnë ndjeshëm pronësinë intelektuale përfshijnë praktikatat e zakonshme të biznesit të njësisë ekonomike, politikat e publikuara ose deklaratat specifike. Megjithatë jo përcaktuese, ekzistenca e interesave ekonomike të përbashkëta (për shembull, një pagesë për përdorimin e pronës e bazuar në shitjet) mes njësisë ekonomike dhe klientit, të lidhura me pronësinë intelektuale për të cilën klienti ka të drejtë, mund të tregojë gjithashtu, se klienti mund të presë në mënyrë të arsyeshme që njësi ekonomike do të ndërmarrë aktivitete të tilla.

B59A Aktivitetet e një njësie ekonomike ndikojnë ndjeshëm në pronësinë intelektuale, për të cilën klienti ka të drejta kur:

- (a) ato aktivitete pritet të ndryshojnë ndjeshëm formën (për shembull, paraqitjen ose përmbajtjen) ose funksionalitetin (për shembull, aftësinë për të kryer një funksion ose detyrë) të pronësisë intelektuale; ose
- (b) aftësia e klientit për të përfituar nga pasuria intelektuale, rrjedh në mënyrë thelbësore nga këto aktivitete ose varet nga këto aktivitete. Për shembull, përfitimi nga një markë shpesh rrjedh nga ose varet nga aktivitetet e vazhdueshme të njësisë ekonomike që mbështesin ose ruajnë vlerën e pronësisë intelektuale.

Prandaj, nëse pronësia intelektuale në vetvete, për të cilën klienti ka të drejta, ka funksionalitet të konsiderueshëm, një pjesë e konsiderueshme e përfitimit të kësaj pronësie intelektuale rrjedh nga funksionaliteti. Rrjedhimisht, aftësia e klientit për të përfituar nga kjo pronësi intelektuale nuk do të ndikohet ndjeshëm nga aktivitetet e njësisë ekonomike përveç nëse këto aktivitete ndryshojnë dukshëm formën ose funksionalitetin e saj. Llojet e pronësisë intelektuale që shpesh kanë funksione të rëndësishme të veçanta, përfshijnë programet kompjuterike, komponentët biologjik ose formula të ilaçeve dhe produkte të përfunduara të medias (për shembull, filmat, shfaqjet televizive dhe regjistrimet muzikore).

B60 Nëse plotësohen kriteret në paragrafin B58, njësia ekonomike duhet ta trajtojë premtimin për dhënie license si një kusht performance që plotësohet gjatë kohës së kontratës, sepse klienti do të marrë dhe konsumojë njëkohësisht përfitimet nga performanca e njësisë ekonomike nëpërmjet dhënies së të drejtës së aksesit në pronësinë e saj intelektuale ndërsa ndodh performanca (shih paragrafin 35(a)). Njësia ekonomike do të zbatojë paragrafët 39–45 për të zgjedhur një metodë të përshtatshme të matjes së progresit të saj ndaj plotësimit të atij kushti performance për të patur akses (te drejte).

B61 Nëse kërkesat e paragrafit B58 nuk plotësohen, natyra e premtimit të njësisë ekonomike është që të jepet një e drejtë për përdorimin e pronësisë intelektuale të njësisë ekonomike për sa kohë që pronësia intelektuale ekziston (në terma të formës dhe funksionimit) në momentin kohor në të cilin licensa i jepet klientit. Kjo do të thotë se klienti mund të menaxhojë drejtpërdrejt dhe të marrë pothuajse të gjitha përfitimet e mbetura nga licensa në momentin kohor në të cilin licensa transferohet. Njësia ekonomike do të trajtojë premtimin për të dhënë një të drejtë për përdorimin e pronësisë intelektuale të njësisë ekonomike, si një kusht performance që plotësohet në një moment kohor të caktuar. Njësia ekonomike do të zbatojë paragrafin 38 për të përcaktuar momentin kohor në të cilin licensa transferohet tek klienti. Megjithatë, të ardhurat nuk mund të njihen për një licensë që jep të drejtën e përdorimit të pronësisë intelektuale të njësisë ekonomike para fillimit të periudhës gjatë së cilës klienti është në gjendje ta përdorë dhe përfitojë prej licenses. Për shembull, nëse periudha për një licensë software fillon para se njësia ekonomike të japë (ose të vërë në dispozicion) tek klienti, një kod i cili i jep mundësi klientit të shfrytëzojë menjëherë software-in, njësia ekonomike nuk do të njohë të ardhura para se kodi të jetë dhënë (ose të jetë vënë në dispozicion).

B62 Një njësi ekonomike nuk do të marrë në konsideratë faktorët në vijim kur përcakton nëse një licensë jep një të drejtë për akses në pronësinë intelektuale të njësisë ekonomike apo një të drejtë për përdorim të pronësisë intelektuale të njësisë ekonomike.

- (a) Kufizimet në kohë, në zona gjeografike apo në përdorim - këto kufizime përcaktojnë më tepër cilësitë e licensës së premtuar dhe nuk përcaktojnë nëse njësia ekonomike plotëson kushtin e saj të performancës në një moment të caktuar kohor apo përgjatë kohës së kontratës.
- (b) Garancitë e dhëna nga njësia ekonomike se ajo ka një patentë të vlefshme për pronësinë intelektuale dhe që ajo do ta mbrojë këtë patentë nga përdorimi i paautorizuar -një premtim për të mbrojtur një të drejtë patente nuk është një kusht performance, sepse veprimi i mbrojtjes së patentës mbron vlerën e aktiveve të pronësisë intelektuale të njësisë ekonomike dhe jep siguri tek klienti se licensa e transferuar plotëson cilësitë (specifikat) e licensës së premtuar në kontratë.

Pagesat për përdorimin e pronës të bazuara në shitje ose në përdorim

B63 Pavarësisht kërkesave në paragrafët 56–59, njësia ekonomike do të njohë të ardhurat nga pagesat për përdorimin e pronës të bazuara në shitje ose në përdorim, në këmbim të një license për pronësinë intelektuale vetëm kur (ose gjatë kohës që) ndodhin ngjarjet në vijim:

- (a) ndodh shitja ose përdorimi i mëpasshëm; dhe
- (b) është realizuar plotësisht (ose pjesërisht) kushti i performancës, për të cilin është shpërndarë një pjesë ose e gjithë pagesa për përdorimin e pronës bazuar në shitje ose në përdorim.

B63A Kërkesa për pagesë për përdorimin e pronës të bazuar në shitje ose të bazuar në përdorim në paragrafin B63 zbatohet kur pagesa lidhet vetëm me një licensë të pronësisë intelektuale ose kur një licensë e pronësisë

SQARIME PËR SNRF 15 TË ARDHURAT NGA KONTRATAT ME KLIENTËT - PRILL 2016

intelektuale është elementi mbizotërues me të cilin lidhet pagesa (për shembull, licenca e pronës intelektuale mund të jetë pika mbizotëruese me të cilën lidhet pagesa, kur njësi ekonomike ka një pritshmëri të arsyeshme që klienti të japë më shumë vlerë në licencë sesa tek mallrat ose shërbimet e tjera me të cilat lidhet pagesa).

- B63B** Kur plotësohet kërkesa në paragrafin B63A, të ardhurat nga pagesa për përdorimin e pronës e bazuar në shitje ose e bazuar në përdorim, njihen tërësisht në përputhje me paragrafin B63. Kur kërkesa në paragrafin B63A nuk është plotësuar, kërkesat për shumën e ndryshueshme në paragrafët 50-59 zbatohen për pagesat e bazuar në shitje ose në përdorim.

Në Shtojcën C, janë ndryshuar paragrafët C2, C5 dhe C7 dhe janë shtuar paragrafët C1B, C7A dhe C8A. Teksti i fshirë është vijëzuar në mes dhe teksti i ri është nënvizuar. Paragrafët C3 dhe C6 nuk janë ndryshuar, por janë përfshirë për lehtësi referimi.

Data e hyrjes në fuqi

- C1B** *Sqarimet në SNRF 15 Të Ardhurat nga Kontratat me Konsumatorët, të publikuara në Prill 2016, ndryshuan paragrafët 26, 27, 29, B1, B34-B38, B52-B53, B58, C2, C5 dhe C7, fshinë paragrafin B57 dhe shtuan paragrafët B34A, B35A, B35B, B37A, B59A, B63A, B63B, C7A dhe C8A. Një njësi ekonomike duhet të aplikojë këto ndryshime për periudhat vjetore raportuese që fillojnë në datën 1 Janar 2018 ose pas kësaj date. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.*

Periudha kalimtare

- C2** Për qëllime të kërkesave në paragrafët C3–C8A për periudhën kalimtare:
- (a) data e zbatimit fillestar është fillimi i periudhës të raportimit në të cilën njësi ekonomike zbaton për herë të parë këtë Standard; dhe
 - (b) një kontratë e përfunduar është kontrata për të cilën njësi ekonomike ka transferuar të gjitha mallrat ose shërbimet e identifikuara në përputhje me SNK 11 *Kontratat e Ndërtimit*, SNK 18 *Të ardhurat* dhe Interpretimet përkatëse.
- C3** Njësi ekonomike duhet ta zbatojë këtë Standard duke përdorur njërin nga dy metodat në vijim:
- (a) në mënyrë retrospektive për çdo periudhë raportimi të mëparshme të paraqitur në përputhje me SNK 8 *Politikat kontabël*, *Ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet*, subjekt i masave thjeshtëzuese të paragrafit C5; ose
 - (b) në mënyrë retrospektive, duke njohur efektin e akumuluar të zbatimit fillestar të këtij Standardi në datën e zbatimit për herë të parë në përputhje me paragrafët C7–C8.
- ...
- C5** Kur zbaton këtë Standard në mënyrë retrospektive sipas paragrafit C3(a), njësi ekonomike mund të përdorë një ose më shumë nga masat thjeshtëzuese në vijim:
- (a) për kontratat e përfunduara, një njësi ekonomike nuk ka nevojë të riparaqesë kontratat që:
 - (i) fillojnë dhe përfundojnë brenda së njëjtës periudhe raportuese; ose
 - (ii) janë kontrata të përfunduara në fillim të periudhës më të hershme të paraqitur.
 - (b) për kontratat e përfunduara, të cilat kanë një shumë korresponduese të ndryshueshme, njësi ekonomike mund të përdorë më mirë çmimin e transaksionit në datën në të cilën kontrata ka përfunduar dhe jo të vlerësojë shumën e ndryshueshme në periudhat krahasuese të raportimit; ~~dhe~~
 - (c) Për kontratat që janë modifikuar para fillimit të periudhës më të hershme të paraqitur, një njësi ekonomike nuk ka nevojë të riparaqesë në mënyrë retrospektive kontratën për ato modifikime të kontratës në përputhje me paragrafët 20-21. Në vend të kësaj, një njësi ekonomike do të pasqyrojë efektin total të të gjitha modifikimeve që ndodhin para fillimit të periudhës më të hershme të paraqitur kur.

- (i) identifikon detyrimet e përmbushura dhe të papërmbushura të performancës;
 - (ii) përcakton çmimin e transaksionit; dhe
 - (iii) shpërmdan çmimin e transaksionit në detyrimet e përmbushura dhe të papërmbushura të performancës.
- (e)(d) për të gjitha periudhat e raportimit të paraqitura para datës së zbatimit për herë të parë, njësia ekonomike nuk ka nevojë të japë informacion shpjegues për shumën e çmimit të transaksionit të shpërndarë për kushtet e mbetura të performancës dhe një shpjegim se kur ajo pret që ta njohë atë shumë si të ardhur (shih paragrafin 120).
- C6 Çdo lehtësi praktike të paragrafit C5 që njësia ekonomike përdor, ajo duhet ta zbatojë në mënyrë uniforme për të gjitha kontratat brenda të gjitha periudhave të raportimit të paraqitura. Gjithashtu, njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese mbi të gjitha sa vijon:
- (a) lehtësitë praktike të përdorura; dhe
 - (b) për sa të jetë e mundur, një vlerësim cilësor të efektit të vlerësuar të zbatimit të secilit prej këtyre lehtësive praktike.
- C7 Nëse një njësi ekonomike zgjedh të zbatojë këtë Standard në mënyrë retrospektive në përputhje me paragrafin C3(b), ajo duhet të njohë efektin e akumuluar të zbatimit fillestar të këtij Standardi si një rregullim në tepicën e çeljes të fitimeve të pashpërndara (ose të një përbërësi tjetër të kapitalit neto, cilido të jetë më i përshtatshëm) të periudhës vjetore të raportimit që përfshin datën e zbatimit për herë të parë. Sipas kësaj metode kalimtare, njësia ekonomike ~~duhet mund të zgjedhë të zbatojë~~ këtë Standard në mënyrë retrospektive vetëm në kontratat që nuk janë përfunduar në datën e zbatimit për herë të parë (për shembull, 1 Janar 2018 për një njësi ekonomike me 31 Dhjetorin si datë të fundit të vitit).
- C7A Një njësi ekonomike që zbaton këtë Standard në mënyrë retrospektive në përputhje me paragrafin C3 (b), gjithashtu, mund të përdorë qëllimin e volitshëm të përshkruar në paragrafin C5 (c), ose:
- (a) për të gjitha modifikimet e kontratës që ndodhin para fillimit të periudhës më të hershme të paraqitur; ose
 - (b) për të gjitha modifikimet e kontratës që ndodhin para datës së aplikimit fillestar.
- Nëse një njësi ekonomike përdor këtë praktikë të volitshme, njësia ekonomike do ta zbatojë atë në mënyrë të qëndrueshme për të gjitha kontratat dhe të japë informacionin e kërkuar në paragrafin C6.
- ...
- C8A Një njësi ekonomike do të zbatojë Sqarimet në SNRF 15 (shih paragrafin C1B) në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8. Në zbatimin e ndryshimeve në mënyrë retrospektive, një njësi ekonomike duhet të zbatojë ndryshimet sikur ato të ishin përfshirë në SNRF 15 në datën e aplikimit fillestar. Rrjedhimisht, një njësi ekonomike nuk zbaton ndryshimet për periudhat raportuese ose për kontratat në të cilat kërkesat e SNRF 15 nuk zbatohen në përputhje me paragrafët C2-C8. Për shembull, nëse një njësi ekonomike zbaton SNRF 15 në përputhje me paragrafin C3 (b) vetëm për kontratat që nuk janë kontrata të përfunduara në datën e zbatimit fillestar, njësia ekonomike nuk riparaqet kontratat e përfunduara në datën e zbatimit fillestar të SNRF 15 për efektet e këtyre ndryshimeve.

Transferimet e Aktiveve Afatgjatë Materiale të Investuara

(Ndryshime SNK 40)

Ndryshime të SNK 40 Aktiv afatgjatë material i investuar

Janë ndryshuar paragrafët 57-58. Teksti i fshirë është shënuar me vijë në mes dhe teksti i ri është nënvizuar.

Transferimet

57 ~~Transferimet. Një njësi ekonomike do të transferojë një pasuri për në ose nga aktivi afatgjatë material i investuar do të bëhen vetëm, dhe vetëm kur ka një ndryshim në përdorim, i provuar nga. Një ndryshim në përdorim ndodh kur prona përmbush ose pushon së përmbushuri, përkufizimin e aktivit afatgjatë material të investuar dhe ka prova të ndryshimit në përdorim. Në veçanti, një ndryshim në qëllimet e drejtimit për përdorimin e një prone nuk përbën provë të një ndryshimi në përdorim. Shembuj të provave të një ndryshimi në përdorim përfshijnë:~~

- (a) fillimi i zotërimit nga pronari, ose i zhvillimit me qëllim të zotërimit të pronarit, për një transferim nga aktiv afatgjatë material i investuar në pasuri të zotëruar nga pronari;
- (b) fillimi i zhvillimit me qëllim shitje, për transferimin e aktivit afatgjatë material të investuar në inventarët;
- (c) përfundimi i përdorimit nga pronari, për një transferim nga një pasuri e zotëruar nga pronari në një aktiv afatgjatë material të investuar; ose dhe
- (d) ~~fillimi zanafilla~~ e një qiraje operative për një palë tjetër, për një transferim nga inventarët në aktivin afatgjatë material të investuar.
- (e) [fshirë]

58 ~~Paragrafi 57(b) kërkon që njësia ekonomike të transferojë aktivin nga aktiv afatgjatë material të investuar në inventar kur, dhe vetëm kur, ka një ndryshim në përdorim, evidentuar qysh prej fillimit të zhvillimit me qëllim shitjeje. Kur një njësi ekonomike vendos të nxjerrë jashtë përdorimit një aktiv afatgjatë material të investuar pa e zhvilluar atë, ajo vazhdon ta trajtojë aktivin si të tillë deri sa ai çregjistrohet (hiqet nga pasqyra e pozicionit financiar) dhe nuk ~~trajtohet~~ riklasifikohet si inventar. Po kështu, nëse njësia ekonomike fillon të rihvillojë një aktiv afatgjatë material të investuar ekzistues për përdorim të vazhdueshëm në të ardhmen si aktiv të tillë, atëherë ai mbetet si aktiv afatgjatë material i investuar dhe nuk riklasifikohet si pasuri e zotëruar nga pronari gjatë rihvillimit.~~

...

Janë shtuar paragrafët 84C-84E dhe titujt përkatës dhe është shtuar paragrafi 85G

Dispozitat kalimtare

...

Transferimet e aktiveve afatgjatë materiale të investuara

- 84C *Transferimet e Aktiveve Afatgjatë Materiale të Investuara* (Ndryshime në SNK 40), i publikuar në Dhjetor 2016, ndryshoi paragrafët 57-58. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime për ndryshimet në përdorim që ndodhin në datën e fillimit të periudhës raportuese vjetore në të cilën njësi ekonomike zbaton më parë këto ndryshime (data e aplikimit fillestar) e në vijim. Në datën e aplikimit fillestar, një njësi ekonomike do të rivlerësojë klasifikimin e pronave që ka në atë datë dhe, nëse është e zbatueshme, riklasifikimin e pronave sipas paragrafëve 7-14 për të pasqyruar kushtet që ekzistojnë në atë datë.
- 84D Pavarësisht nga kërkesat në paragrafin 84C, njësi ekonomike lejohet të zbatojë ndryshimet në paragrafët 57-58 në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8, nëse dhe vetëm nëse kjo është e mundur pa përdorimin e paragjykit.
- 84E Nëse, në përputhje me paragrafin 84C, një njësi ekonomike riklasifikon pronat në datën e aplikimit fillestar, njësi ekonomike do të:
- (a) bëjë riklasifikimin duke zbatuar kërkesat në paragrafët 59-64. Në zbatimin e paragrafëve 59-64, një njësi ekonomike do të:
 - (i) lexojë çdo referencë me datën e ndryshimit të përdorimit si data e aplikimit fillestar; dhe
 - (ii) njohë çdo shumë që, në përputhje me paragrafët 59-64, do të ishte njohur në fitim ose humbje si një rregullim në tepicën e çeljes së fitimeve të pashpërndara në datën e aplikimit fillestar.
 - (b) japë informacione shpjeguese për shumën e riklasifikuar në ose nga aktive afatgjatë materiale të investuara në përputhje me paragrafin 84C. Njësi ekonomike do të japë informacion shpjegues për këto shuma të riklasifikuara si pjesë e rakordimit të vlerës kontabël të aktivitetit afatgjatë material të investuar në fillim dhe në fund të periudhës, siç kërkohet në paragrafët 76 dhe 79.

Data e hyrjes në fuqi

...

- 85G *Transferimet e Aktiveve Afatgjatë Materiale të Investuara* (Ndryshime në SNK 40), i publikuar në Dhjetor 2016, ka ndryshuar paragrafët 57-58 dhe 84C-84E. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore nga data 1 janar 2018 e në vazhdim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

